



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 17 regjistër (JR)
Datë 13.09.2018

Nr. 6 i vendimit
Datë 28.02.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Luan Daci	Kryesues
Sokol Çomo	Relator
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 28.02.2019, ora 12:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 17/2018 (JR), datë 13.09.2018, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 42, datë 18.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin

Publik, i cili përfundimisht bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, dhe shkarkimin e saj nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Antoneta Sevdari, e cila kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit në vitin 2002 ka filluar stazhin profesional si prokurore (duke qenë studente e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës), kurse në vitin 2003 e në vijim ka ushtruar detyrën e prokurores dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte detyrën e prokurores në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 279, pika 4 e ligjit nr. 115/2016¹ “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, duke qenë se ishte kandidatë për anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor², në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht, deklaratën e pasurisë³, deklaratën për kontrollin e figurës⁴, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁵.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹ Neni 279, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon:
“4. Brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit bën rivlerësimin e prokurorëve që kandidojnë. [...]”

² Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

³ Dorëzuar pranë ILDKPKI më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI nr. extra prot., datë 25.01.2017.

⁴ Dorëzuar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar më datë 24.01.2017.

⁵ Dorëzuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme, më datë 24.01.2017, provuar kjo sipas raportit të grupit të punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, “Për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Antoneta Sevdari për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, me nr. {***} prot. ex {***}, datë 16.01.2018 (f. 2 e raportit).

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me anë të të cilit përcakton se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, nuk ka informacione që tregojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar dhe, për rrjedhojë, konstaton përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, për vazhdimin e detyrës.
5. Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 42, datë 18.07.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni me vendimin nr. 42, datë 18.07.2018, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, me funksion prokurore në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1 Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, trupi gjykues bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficientë dhe proporcionalitetit, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, pasi vlerësoi provat dhe shpjegimet e paraqitura dhe i analizoi ato, arrin në përfundimin se: Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u konstatua se deklaratimet janë bindëse, të sakta dhe në përputhje me ligjin. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.

8.2 Në lidhje me kontrollin e figurës, nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës

dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si prokuror.

8.3 Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, relatori i çështjes, pasi hetoi raportin e grupit të punës të ngritur pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe denoncimet e marra në emër të subjektit të rivlerësimit, konstatoi se nuk u gjet asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficientë dhe efektive në masë të pranueshme dhe konsiderohet “e aftë” profesionalisht.

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Darjel Sina, më datë 29.08.2018, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, duke pretenduar se procesi i hetimit të Komisionit, për këto dy kritere, shfaq mangësi dhe, për rrjedhojë, referuar kërkesave të neneve D dhe E të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit, në vështrim të provave të administruara, nuk të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe nivel të mirë kualifikues të aftësive profesionale.

10. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurive paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

10.1 Verifikimi i ligjshmërisë së shumës prej 3.000.000 lekësh (përfshirë shumën prej 12.000 eurosh, të siguruar nga puna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Arabinë Saudite), të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burimi i krijimit të pasurisë për pjesën takuese 1/3 e truallit + ndërtesë, në Yzberisht, Tiranë, për të cilën Komisioneri Publik pretendon se Komisioni nuk ka hetuar dhe nuk ka administruar dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Gjithashtu, Komisioneri Publik parashtron në ankimin e tij se objekti i kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, shtrihet edhe ndaj pasurive të fituara para fillimit të detyrës së subjektit, për sa kohë kriteri i kontrollit të pasurive nuk kufizohet apo kushtëzohet nga momenti i fillimit të detyrës apo për këtë kriter nuk përcaktohet periudhë vlerësimi, si në rastin e kriterit të aftësive profesionale.

Në lidhje me të ardhurat me burim emigracionin e bashkëshortit të subjektit në Greqi për periudhën 1997-2000, Komisioneri pretendon që hetimi i Komisionit ka qenë i mangët në drejtim të administrimit të dokumentacionit provues mbi ligjshmërinë e burimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura, si dhe të aftësisë së personit të lidhur për të kursyer gjatë kësaj periudhe.

Sa u takon të ardhurave në vlerën prej 12.000 eurosh, të deklaruara si të realizuara nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2003, nga puna në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Komisioneri kundërshton vendimin e Komisionit për mungesë hetimi dhe administrimi të dokumentacionit që provon mënyrën e kryerjes së pagesës dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura.

10.2 Verifikimi i ligjshmërisë së shumës prej 19.975,23 USD, të dekluar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006, si e ardhur nga puna e bashkëshortit në Arabinë Saudite, për të cilën Komisioneri Publik pretendon se Komisioni është mjaftuar me gjendjen e faktit dhe konfirmimin e transfertës bankare dhe nuk ka hetuar dhe administruar dokumentacionin provues për ligjshmërinë e kësaj të ardhure, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri lidhur me këto të ardhura pretendoi në ankim edhe deklarim të pasaktë të vlerës së tyre nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2006.

10.3 Verifikimi i vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimit për vitin 2010, lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, person fizik tatimpagues, në shumën 3.171.510 lekë, shumë kjo e cila ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament me sipërfaqe 101 m² në Tiranë. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) si fitim i realizuar nga aktiviteti ekonomik për vitin 2010, për të cilat Komisioni është shprehur se deklaratimet e subjektit përputhen me rezultatet e hetimit, Komisioneri Publik pretendon se ky konkluzion i Komisionit është rezultat i një hetimi të mangët (duke marrë në konsideratë përgjigjet kontradiktore të administruara nga organi tatimor) dhe mosvlerësimi të drejtë të çështjes në lidhje me të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

10.4 Verifikimi i ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga veprimtaria ekonomike e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 3.299.805 lekë, për vitin 2016 në raport me pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse, duke qenë se sipas Komisionerit Publik personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit), i regjistruar si person fizik tregtar në datën 02.08.2017, rezulton me detyrime tatimore të pashlyera në vlerën 337.104 lekë. Gjatë diskutimeve në seancë gjyqësore, Komisioneri Publik pretendoi edhe mospagim të taksave vendore pranë Drejtorisë së Taksave të Bashkisë Tiranë.

11. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale bazohen në pretendimin mbi mungesën e hetimit dhe vlerësimit nga ana e Komisionit të të gjitha denoncimeve të ardhura nga publiku, të cilat sipas ankimit mund të përbëjnë indicie të mjaftueshme për një vlerësim të kundërt për këtë kriter, parë këto edhe në dritën e rezultateve të hetimit lidhur me një prej pesë dosjeve penale të shortuara për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, referuar në vendimin e Komisionit si Rasti 5⁶. Më konkretisht:

11.1 Komisioneri Publik lidhur me dhjetë denoncimet e publikut të depozituara në Komision, pretendon se për disa prej tyre hetimi ka munguar plotësisht, duke përmendur për ilustrim denoncimet e tre shtetasve, si dhe katër raste të tjera, në të cilat, sipas Komisionerit Publik, edhe

⁶ Rasti 5 i referohet një prej dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor të realizuar nëpërmjet shortit, për efekt të vlerësimit profesional, sipas nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka humbur afatin ligjor për ushtrimin e ankimit kundër vendimit nr. {***}, datë 21.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me të pandehurin G. D. (shih f. 14 të vendimit të Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018, për subjektin e rivlerësimit Antoneta Sevdari).

pse Komisioni ka kërkuar dokumentacion, në vendimin përfundimtar të tij nuk ka reflektuar asnjë trajtim dhe vlerësim lidhur me këto denoncime.

11.2 *Në lidhje me trajtimin nga Komisioni të dosjes penale të përzgjedhur për vlerësim, referuar si Rasti 5, Komisioneri Publik pretendon se fakti i pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit për mosnjohjen mjaftueshëm të praktikës gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të “rastit faktor” ngre dyshime për aftësinë profesionale të saj dhe se, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit paraqet mungesë të njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, si dhe mungesë të aftësisë organizative, në referencë të nenit 74 të të njëjtit ligj, duke rezultuar në moskryerjen e detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit.*

12. Komisioneri Publik në ankimin e tij kërkoi marrjen në shqyrtim të shkaqeve të sipërcituara, kryerjen e një hetimi të plotë për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, në përfundim të gjykimit nga ana e Kolegjit, në zbatim të nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik në ankimin e tij kërkoi, në mënyrë alternative:
- Ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

IV. Shpjegimet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit

13. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi ankimin e Komisionerit Publik në tërësi dhe pretendoi se vendimi i Komisionit objekt ankimi, është marrë në përfundim të një hetimi të plotë administrativ dhe konkluzionet e arritura në këtë vendim janë në përputhje të plotë me parashikimet e bëra në Aneksin e Kushtetutës, si dhe me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, kërkoi mospranimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018, dhe lënien e tij në fuqi.
14. Lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurive, subjekti argumentoi si vijon:

14.1 Sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik mbi të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë truall + ndërtesë (1/3 pjesë takuese), në Yzberisht, Tiranë, subjekti në radhë të parë kundërshtoi përfshirjen në procesin e verifikimit, në kuadër të ligjit nr. 84/2016, të pasurive të krijuara përpara fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit dhe sidomos në rastet kur pasuritë rezultojnë të krijuara me të ardhura të përfituara nga personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe jo nga ky i fundit.

14.2 Përveç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se lidhur me shumën prej 3 000 000 lekësh, të deklaruar si burim për krijimin e pasurisë së sipërcituar, një pjesë e së cilës është krijuar nga emigracioni i bashkëshortit në Greqi gjatë viteve 1997-2000, kurse pjesa tjetër në vlerën prej 12 000 eurosh, nga puna e bashkëshortit në Mbretërinë e Arabisë Saudite në periudhën qershor - nëntor 2003, subjekti dhe personi i lidhur me të kanë dorëzuar pranë ILDKPKI-së dhe Komisionit të gjithë dokumentacionin që kanë mundur të gjejnë (pasi kanë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme, duke pasur parasysh edhe kohën e gjatë që ka kaluar nga vitet e emigracionit dhe faktin që bashkëshorti nuk ka pasur detyrim për ruajtjen e këtij dokumentacioni), me anë të të cilit provojnë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre të ardhurave, që është puna ndershme e

bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në shtetin e Greqisë dhe atë të Arabisë Saudite.

14.3 Në lidhje me të ardhurat e deklaruara në vlerën 12000 Euro, si të krijuara nga puna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Arabinë Saudite në vitin 2003, për llogari të shoqërisë {***}ShPK, subjekti pretendoi se dokumentacioni i administruar në Komision provon burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre të ardhurave, shumën e përfituar, si dhe faktin që kjo e ardhur është siguruar pa shkelur parashikimet e legjislacionit tatimor nga personi i lidhur, duke qenë se detyrimi për të mbajtur në burim tatimin dhe pagimin e tij pranë autoriteteve tatimore e ka pasur shoqëria që ka kontraktuar shërbimin dhe ka kryer pagesën. Gjithashtu, duke qenë se kjo pagesë është përfituar *cash*, subjekti pretendoi se bashkëshorti i saj nuk mund të verifikonte pagimin ose jo të detyrimeve tatimore nga shoqëria {***}ShPK.

14.4 Lidhur me shkakun e ngritur në ankim mbi ligjshmërinë e të ardhurave në vlerën e 19975,23 dollarëve amerikanë, me burim krijimi punën e personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) në Mbretërinë e Arabisë Saudite gjatë vitit 2006, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se këto të ardhura provohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm që janë të ardhura të realizuara nga personi i lidhur, “si rezultat i një pune të ligjshme dhe të ndershme”. Në kundërshtim me sa pretendon Komisioneri Publik, subjekti pretendoi se për efekt të të provuarit të burimit të ligjshëm të këtyre të ardhurave, janë administruar një sërë aktesh shkresore. Sa i takon çështjes së pagesës së tatimeve lidhur me këto të ardhura, subjekti pretendoi se në kohën e krijimit të tyre nuk ka qenë i përcaktuar me ligj detyrimi i plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës integrale⁷, si dhe mënyra e pagesës së tatimit mbi të ardhurat e fituara jashtë Shqipërisë. Për rrjedhojë, personi i lidhur nuk ka pasur detyrim të deklarojë pranë organeve tatimore shqiptare të ardhurat e realizuara nga punësimi në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

14.5 Sa i takon shumës së mbajtur si tatim në burim në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe dokumentacionit provues lidhur me pagimin e saj në vendin e burimit, subjekti pretendoi pamundësi për të shpjeguar dhe dokumentuar këtë fakt, pavarësisht përpjekjeve të mundshme në këtë drejtim.

14.6 Në lidhje me shkakun e ankimit mbi verifikimin e ligjshmërisë së shumës prej 3.171.510 lekësh, të dekluarar si fitim neto nga aktiviteti ekonomik i personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) për vitin 2010, subjekti sqaroi se informacioni i përcjellë nga organet tatimore nuk është kontradiktor, përkundrazi konfirmon vlerën e fitimit, deklarin dhe pagesën në kohë të tatimit mbi këtë fitim të realizuar për vitin fiskal 2010 dhe se mungesa e informacionit në sistemin elektronik të administratës tatimore për fitimin e realizuar për këtë vit nga personi fizik tatimpagues, u provua gjatë hetimit administrativ në Komision, që është rezultat i ngecjes në sistemin *online* të deklarimit, të formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit për biznesin e vogël.

14.7 Sa i takon shkakut të ankimit lidhur me verifikimin e ligjshmërisë së shumës prej 3.299.805 lekësh, të dekluarar si fitim neto i realizuar nga aktiviteti ekonomik i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë vitit 2016, si pasojë e detyrimeve tatimore të pashlyera në vlerën prej 337.104 lekësh deri në datën 02.08.2017, subjekti sqaroi se detyrimet e pashlyera për të cilat shprehet në

⁷ Me miratimin e ligjit nr. 9326, datë 06.12.2004, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 13 të ligjit bazë u përcaktua edhe detyrimi i çdo individi për të deklaruar sipas “deklaratës tatimore integrale për të ardhurat personale”, të ardhurat e realizuara nga çdo burim gjatë një viti, pavarësisht nëse këto të ardhura janë tatuar apo janë ose jo të tatueshme. Detyrimi për deklarim sipas këtij neni u përcaktua për zbatim në disa faza.

shkresat e tij organi tatimor nuk lidhen me tatimin mbi fitimin e realizuar për këtë vit, i cili referuar legjislacionit të zbatueshëm, për xhiron e realizuar deri në 5.000.000 lekë, ka qenë 0 lek, por me detyrime TVSh-je dhe detyrime të pagesës së kontributeve të detyrueshme për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në një vlerë relativisht të vogël, të cilat janë shlyer në vazhdim. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik, ngritur në seancë gjyqësore, për mungesë provash lidhur me pagesën e detyrimeve ndaj Drejtorisë së Taksave të Bashkisë Tiranë, subjekti pretendoi se pagesa e tyre është kryer dhe ky fakt provohet në dokumentacionin e administruar në fashikullin gjyqësor.

15. Në lidhje me shkakun e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, subjekti kundërshtoi qëndrimin e Komisionerit Publik, përkatësisht:

15.1 Për mungesën e hetimit të denoncimeve të paraqitura në Komision, duke parashtruar se hetimi, për secilin prej tyre, që paraqiste të dhëna që mund të ishin objekt vlerësimi për Komisionin sipas kornizave të ligjit nr. 84/2016, kish qenë i plotë. Për pasojë, edhe konkluzioni i arritur nga Komisioni, se në asnjë prej këtyre denoncimeve nuk u gjet asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurores, kish qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj.

15.2 Për trajtimin nga Komisioni të Rastit 5, sipas të cilit në trajtimin e çështjes penale në fjalë subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mungesë të aftësive profesionale dhe atyre organizative sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, me argumentin se këto konkluzione nuk mbështeten as në ligj dhe as në aktet dhe të dhënat e administruara gjatë hetimit në Komision. Subjekti pretendoi që rasti në fjalë është një ngjarje njerëzore, e cila ka ndodhur për shkaqe familjare, të cilat provohen nga aktet e administruara gjatë hetimit dhe, për më tepër, njohja me praktikën gjyqësore në mënyrë të vazhdueshme, është shprehje profesionalizmi dhe jo e kundërta.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

16. Në përputhje me nenin 179/b, pika e të Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

17. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione*

temporis pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁸ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

18. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve në datat 13, 19, 25 dhe 28 shkurt 2019.
19. Lidhur me kërkesën e Komisionerit Publik për riçeljen e hetimit, trupi gjykues, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve lidhur me ankimin, si dhe:

(i) vlerësoi faktin që kërkesat e Komisionerit Publik për hetime të mëtejshme, për secilin shkak të ankimit të ngritur prej tij, lidhur me të dyja kriteret objekt ankimi, ishin të përgjithshme dhe nuk identifikonin as burimin e provave, as veprimet e nevojshme hetimore nga ana e Kolegjit;

(ii) vlerësoi se barra e provës në procesin e rivlerësimit kalimtar referuar nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës qëndron te subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, e cila nuk kërkoi riçeljen e hetimit dhe marrjen e provave të reja, me pretendimin se hetimi i kryer nga ana e Komisionit ishte i plotë, duke u mjaftuar vetëm me prezantimin në seancë gjyqësore të disa akteve shkresore dhe fotografive, bashkëlidhur parashtrimeve të saj. Lidhur me këto akte, subjekti i rivlerësimit nuk bëri kërkesë në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 për marrjen e tyre si provë, duke e lënë vlerësimin e tyre në çmimin e Kolegjit. Pavarësisht nga kjo, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “a”, për Kolegjin marrja në cilësinë e provës shkresore dhe fotografike ishte e panevojshme;

me vendim të ndërmjetëm vendosi refuzimin e kësaj kërkesë, duke vlerësuar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen në të cilën janë aktet e administruara gjatë procesit të rivlerësimit në Komision.

B. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit, lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit objekt ankimi

a) Kriteri i vlerësimit të pasurisë

20. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave që kanë shërbyer si burim për krijimin e 1/3 pjesë takuese të pasurisë tokë arë⁹ dhe godinë banimi, ndërtim i legalizuar dhe regjistruar si pasuria me nr. 299/144, zona kadastrale nr. 3866, Yzberisht, Tiranë, në vlerën prej 3.000.000 lekësh (përfshirë këtu edhe shumën prej 12.000 eurosh, të siguruar nga puna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Arabinë Saudite në vitin 2003), trupi gjykues konstaton si më poshtë:

⁸ Referuar akteve të administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 42, datë 18.07.2018, për rivlerësimin e subjektit Antoneta Sevdari, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik më datë 14.08.2018, me shkresën nr. {***} prot., të së njëjtës datë, konfirmuar sipas lajmërim-marrjes së protokolluar pranë këtij institucioni me nr. {***} prot., datë 14.08.2018, ndërsa ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 29.08.2018, protokolluar në Komision me nr. {***}, datë 29.08.2018, që rezulton të jetë dita e 15-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁹ Aktualisht e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme si tokë truall, sipas korrigjimit të bërë me urdhrin nr. {***}, datë 06.06.2017, të regjistruesit të Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.

20.1 Komisioni në vlerësimin dhe kontrollin e ligjshmërisë së burimeve për krijimin e pasurive të sipërcituara, ka arsyetuar në vendimin e tij se këto dy pasuri iu nënshtruan një hetimi të plotë dhe rezultoi se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me to përputheshin me rezultatet e hetimit. Për këto pasuri, trupi gjykues i Komisionit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion, i cili e ka bindur atë lidhur me krijimin e këtyre pasurive, herët në vitet 2000-2002, nga bashkëshorti i saj dhe familjarët e tij. Komisioni është shprehur në vendim se subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, fillimisht nuk ka qenë pjesëtare e kësaj familjeje, më tej ajo ka qenë studente e Shkollës së Magjistraturës dhe nuk ushtronte funksionin e prokurores, duke konkluduar se nuk ka kontribuar në blerjen e kësaj pasurie dhe as ka investuar për ndërtimin e saj.

20.2 Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit sa i takon vlerësimit të pasurive të sipërcituara, duke pretenduar që objekti i kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, shtrihet edhe ndaj pasurive të fituara para fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë kriteri i kontrollit të pasurive nuk kufizohet apo kushtëzohet nga momenti i fillimit të detyrës së subjektit apo nga përcaktimi i periudhës së vlerësimit, si në rastin e kriterit të aftësive profesionale (neni 41/3 i ligjit nr. 84/2016).

20.3 Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi përfshirjen në procesin e verifikimit të pasurive të krijuara përpara fillimit të detyrës, në kuadër të ligjit nr. 84/2016 dhe, sidomos, të rasteve kur pasuritë rezultojnë të krijuara me të ardhura të përfituara nga personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe jo nga ky i fundit, me argumentin se në këto raste përjashtohet çdo mundësi që këto pasuri të jenë krijuar me korrupsion, duke abuzuar me detyrën, apo nga veprimtari të tjera të kundërligjshme që cenojnë figurën dhe integritetin e magjistratit dhe e bëjnë atë të pabesueshëm në sytë e publikut.

20.4 Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues çmon se referuar nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e kontrollit të pasurive kryhet nga organet e rivlerësimit, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, çdo pasuri, sipas kuptimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e ligjit të rivlerësimit, që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklaratimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Në referim të kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, konstatohet se në asnjë prej dispozitave të këtij korpusi ligjor nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kritere vlerësimi, lidhur me pasuritë e subjekteve dhe personave të lidhur, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016.

20.5 Gjithashtu, në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e

Kushtetutës¹⁰ dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin, apo edhe në formën e pranimin të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë.

20.6 Për më tepër, nga interpretimi sistematik i dispozitave të ligjeve të paketës për reformën në drejtësi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se standardi i vendosur në kuadër të kësaj reforme, në lidhje me verifikimin e pasurive të trupës së magjistratëve, kërkon kontrollin e plotë të pasurive të deklaruar, qofshin këto të krijuara para apo pas emërimit në detyrë të magjistratit, për sa kohë, referuar dispozitave të ligjit për statusin e magjistratit, verifikimit të plotë të pasurive, sipas të njëjtave standarde të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm për kontrollin dhe deklarimin e tyre, i nënshtrohen edhe kandidatët për t'u pranuar në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës¹¹, si dhe të diplomuarit prej kësaj shkolle para emërimit të tyre si magjistratë gjyqtarë/prokurorë¹².

20.7 Për sa më sipër, indiferenca e organeve të rivlerësimit ndaj pasurive në pronësi apo përdorim të subjekteve të rivlerësimit, të përfituara në shkelje të detyrimeve ligjore, me argumentin që shkeljet i referohen një periudhe të ndryshme kohore nga ajo e ushtrimit të detyrës nga ana e subjekteve, çmohet nga ana e trupit gjykues se cenon procesin e rivlerësimit, pasi qëllimi i tij do të bëhej i pamundur për t'u përmbushur, sikundër do të përbënte precedent për trajtimin në mënyrë të diferencuar të trupës së magjistratëve që do të jenë pjesë e sistemit të drejtësisë pas reformës së ndërmarrë.

20.8 Në shqyrtim të kundërshtimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues në vijim të analizës së mësipërme nuk pranon si argumentim bindës, qëndrimin e subjektit se në rastin e pasurive të krijuara para fillimit të detyrës, përjashtohet çdo mundësi që këto pasuri të jenë krijuar në saje të akteve korruptive gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit, apo abuzimit të çdo forme të tyre me detyrën apo nga veprimtari të tjera të kundërligjshme që cenojnë figurën dhe integritetin e magjistratit dhe e bëjnë atë të pabesueshëm në sytë e publikut, për sa kohë nuk mund të

¹⁰ Neni 179/b, pika 1 parashikon:

"1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi".

¹¹ Neni 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" parashikojnë:

"1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31 të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës. [...]"

4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve [...]"

¹² Neni 35, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" parashikon:

"1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: [...]"

c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji".

përjashtohet edhe mundësia e fitimit/përdorimit të pasurive në shkelje të ligjit, jashtë periudhës së ushtrimit të detyrës.

20.9 Në konkluzion të sa më sipër, në vlerësimin e rastit objekt gjykimi, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në keqinterpretim të parashikimeve ligjore në fuqi, ka kryer vetëm verifikimin e saktësisë së deklaramit të subjektit lidhur me pasuritë e llojit truall dhe ndërtesë banimi me vendndodhje në Yzberisht, Tiranë, duke mos u shprehur mbi ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të deklaruara për krijimin e tyre. Ky fakt e bën vendimmarrjen e Komisionit të gabuar dhe, për rrjedhojë, të cenueshme sa i takon verifikimit të ligjshmërisë së këtyre burimeve, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

20.10 Në vijim të këtij konkluzioni, trupi gjykues e gjen të bazuar në ligj pretendimin e Komisionerit Publik në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara me burim emigracionin e personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) në Greqi, gjatë viteve 1997-2000, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave në vlerën prej 12.000 eurosh të deklaruara si të realizuara nga puna e kryer nga personi i lidhur në vitin 2003 në Mbretërinë e Arabisë Saudite, për llogari të shoqërisë {***}ShPK.

20.11 Së pari, sa u takon të ardhurave me burim emigracionin, trupi gjykues mban parasysht qëndrimin e Kolegjit në një vendimmarrje të mëparshme, sipas së cilës jo gjithmonë remitancat mund të konsistojnë në dërgesa të vlerave monetare të krijuara nga burime të ligjshme¹³ dhe të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në kuptim të standardit të vendosur nga Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, lidhur me përmbushjen e detyrimeve tatimore përkatëse. Për rrjedhojë, me qëllim që remitancat të vlerësohen në gjykimet pranë Kolegjit, nevojitet që ato të provohen se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit.

20.12 Për efekt të provueshmërisë së kritereve të sipërcituara, në përputhje me nenin 32, pika 1¹⁴ e ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin që, në rastet e deklaramit si burim krijimi të pasurive të tyre të ardhurat nga emigracioni, të paraqesin të gjitha dokumentet që provojnë burimin dhe justifikojnë ligjshmërinë e tij. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se kërkesat e pikës 21 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, në zbërthim të parashikimit kushtetues të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, përmbushen vetëm në saje të administrimit të dokumentacionit që provon ekzistencën e (i) një burimi real të ardhurash dhe (ii) vlerën e të ardhurave të krijuara nga personi deklarues, dhe jo të mundësisë objektive për t'u zënë me punë që ekuivalentohet me mundësinë potenciale për të krijuar të ardhura gjatë periudhës së deklaruar.

¹³ Shih paragrafët 22 dhe 23 të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 12/2018 (JR), datë 17.12.2018.

¹⁴ Neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon:

“1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarameve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

20.13 Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision¹⁵, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë faktin që bashkëshorti i saj ka qenë emigrant ekonomik në Greqi, në periudhën shtator 1997 deri në prill 2000, dhe se nga data 27.01.1998, referuar vërtetimit të lëshuar nga Zyra e Punës, Nea Ionia, Republika Greke, personi i lidhur është deklaruar pranë autoriteteve të shtetit të huaj dhe ka bërë kërkesë për pajisje me leje qëndrimi në këtë shtet. Përtej vërtetimit të këtij fakti, dokumentacioni i dorëzuar pranë ILDKPKI-së bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk arriti të kënaqë kërkesat e nenit 21 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, për sa kohë aktet shpresore të administruara në cilësinë e provës nuk arritën të provojnë faktin e punësimit të personit të lidhur dhe nivelin e të ardhurave të ligjshme të krijuara gjatë kësaj periudhe.

20.14 Për më tepër, trupi gjykues çmon të evidentojë edhe faktin që, edhe pasi u pyet në seancë gjyqësore nga trupi gjykues, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë se sa ishte vlera e të ardhurave të dërguara në Shqipëri nga bashkëshorti në formën e remitancës, duke e bërë të pamundur për trupin gjykues që të vlerësojë edhe mbi ligjshmërinë e kalimit/transferimit të këtyre mjeteve monetare nga vendi i krijimit në vendin e origjinës së emigrantit.

20.15 Së dyti, lidhur me të ardhurat në vlerën e 12000 euro, të deklaruara si të krijuara në vitin 2003, nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Mbretërinë e Arabisë Saudite, për llogari të shoqërisë {***}ShPK, trupi gjykues konstaton se kjo e ardhur është deklaruar për herë të parë vetëm në vitin 2016, në deklaratën e pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe në përgjigjet e dhëna për Komisionin në pyetësonin e datës 26.02.2018, ku subjekti është shprehur: *Në vitin 2003, bashkëshorti punoi për 5 muaj në Arabi Saudite dhe të ardhurat e përfituara për punën e kryer në Arabi Saudite ishin 12000 euro. E gjithë kjo pagesë ka shkuar për të paguar punime të brendshme në banesë në vitin 2003, si dhe një pjesë edhe për mobilim.*

20.16 Nga shqyrtimi i deklaramit të parë të kryer nga subjekti i deklaramit në vitin 2004, në formularin A-6¹⁶, për periudhën 01.01.2003 deri më 31.12.2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në raport me bashkëshortin e saj, vetëm të ardhurën nga paga e bashkëshortit pranë firmës {***}Tiranë, në vlerën 0,36 milion lekë (në vlerë bruto). E pyetur nga trupi gjykues për

¹⁵ Provat e administruara janë:

(i) dokumenti i lëshuar nga Zyra e Punës, Nea Ionia, Republika Greke me titull “Vërtetim A”, lëshuar më datë 27.01.1998, që vërteton se në këtë datë z. A. S. ka depozituar kërkesën për pajisje me “Kartën e lejes së përkohshme të qëndrimit për të huajt”, duke dorëzuar për këtë efekt vetëm pasaportën e tij, evidentuar në dokument nga autoriteti përkatës me shenjën (+) përbri;

(ii) kartë qëndrimi me afat kohor të kufizuar, me periudhë vlefshmërie 06.05.2000 - 05.05.2001; si dhe

(iii) tri mandate të cilat vërtetojnë blerje pullash sigurimi shoqëror nga Instituti Grek i Sigurimeve Shoqërore për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 1998, në të cilat referohen të dhënat e një punëdhënësi (por nuk ka asnjë të dhënë që i siguruari, qoftë edhe për këtë periudhë 3-mujore, të jetë z. A. S.).

¹⁶ Referuar deklaramit të parë të kryer nga subjektet e ligjit në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, sipas Deklaramit Model 5.1, objekti i deklaramit të formularit A-6, përfshinte të ardhurat personale nga paga, pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura, për subjektin dhe të gjithë pjesëtarët e familjes. Në këtë kuptim, detyrimi për deklaramin përfshinte të ardhurën objekt gjykimi jo vetëm për nga lloji i saj, por edhe në kuptim të personit që i kish realizuar këto të ardhura, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e tij si pjesëtar i familjes së subjektit deklarues në përputhje me nenin 21, pika 1 të ligjit të sipërcituar.

arsyen e mosdeklarimit të këtyre të ardhurave në deklarimin e parë të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të jepte një shpjegim bindës dhe të mbështetur në ligj për këtë mosdeklarim.

20.17 Lidhur me këto të ardhura, të deklaruara si të përfituara nga puna e bashkëshortit për periudhën qershor-dhjetor 2003, për llogari të shoqërisë {***}ShPK, nga angazhimi i pretenduar pranë degës së shoqërisë {***} s.p.a. në Mbretërinë e Arabisë Saudite në disa projekte infrastrukturore në këtë vend dhe të cilat, në tërësinë e tyre, sipas shpjegimeve të vetë subjektit gjatë hetimit administrativ, kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë së paluajtshme shtëpi banimi me vendndodhje në Yzberisht, Tiranë dhe mobilimin e saj, trupi gjykues, në analizë të dokumenteve justifikuese të dorëzuara nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe atij të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, çmon se ato përmbajnë indicie lidhur me faktin e angazhimit profesional të personit të lidhur dhe përfitimit prej tij të të ardhurave në këmbim të këtij angazhimi, por jo prova të plota, të mjaftueshme, lidhur me ekzistencën e burimit të ligjshëm të të ardhurave dhe vlerës së tyre të deklaruar prej 12.000 eurosh. Për sa u përket elementeve të tjera thelbësore, siç janë koha dhe mënyra e arkëtimit të pagesave (të ardhurave) nga personi i lidhur, si dhe pagesa e tatimit përkatës, arrihet në konkluzionin se ato mbetën në nivelin e pretendimeve të aprovuara.

20.18 Dokumentacioni i administruar nga Komisioni, që konsiston në deklaratat e shoqërisë {***}ShPK, të datave 05.01.2017 dhe 07.01.2017, me kërkesë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, dhe korrespondencën e datës 22.01.2018-24.01.2018 të Komisionit me shoqërinë në fjalë, nuk arritën të qartësojnë dhe të bindin trupin gjykues për natyrën e marrëdhënieve juridike të krijuara mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe këtyre dy shoqërive tregtare, në raport me shërbimin e ofruar në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe, për rrjedhojë, shpërblimi për shërbimet e personit të lidhur, z. A.S., në vlerën e deklaruar nga subjekti prej 12.000 eurosh dhe të konfirmuar nga shoqëria {***}ShPK në shkresën e datës 05.01.2017, koha dhe mënyra e kryerjes së pagesës së mësipërme, si dhe pagimi i tatimit përkatës, nuk arritën të provoheshin me dokumentacion ligjor.

20.19 Lidhur me këto të ardhura, subjekti shpjegoi se detyrimi për të paguar tatimin mbi to ka qenë i shoqërisë {***}ShPK dhe se subjekti nuk ka pasur mundësi ta verifikojë këtë fakt, duke qenë se pagesat janë kryer në *cash*. Në shqyrtim të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se, në mungesë të dokumentacionit që përcakton llojin e marrëdhënies juridike që ka ekzistuar mes palëve, në të cilën duhet të përcaktoheshin edhe të drejtat dhe detyrimet reciproke të tyre, pretendimi i subjektit që detyrimi për të paguar detyrimet ndaj organeve tatimore ka qenë i shoqërisë {***}ShPK nuk mund të provohet. Megjithatë, lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues çmon se, edhe në rastin që marrëdhënia kontraktuale e supozuar mes palëve ishte e atillë, që detyrimin për mbajtjen në burim të tatimit mbi këtë të ardhur, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar deri në vitin 2003, e kishte shoqëria {***}ShPK, mosdeklarimi i kësaj të ardhure në vitin e krijimit të saj në formularin A-6 të “Deklaratës model 5.1”, të dorëzuar në mars të vitit 2004 nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për

deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049, datë 10.04.2003”), nuk arrin të bindë trupin gjykues që përfitimi i kësaj pagese nga personi i lidhur nuk ka qenë në keqbesim (sa u takon detyrimeve ndaj shtetit). Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mban në konsideratë edhe parashikimin e nenit 35, pika 2 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar deri në vitin 2003¹⁷, sipas të cilit, personi i lidhur kishte të drejtën t’i kërkonte shoqërisë provë të regjistrimeve lidhur me mbajtjen dhe pagimin e tatimit në burim, e drejtë e cila nuk u provua të jetë ushtruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, as gjatë procesit të rivlerësimit dhe as gjatë shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik nga Kolegji.

20.20 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se dokumentacioni justifikues, qoftë sa u takon të ardhurave të deklaruara si të realizuara nga emigracioni i bashkëshortit në Greqi, apo edhe atyre të krijuara nga puna e kryer prej tij në vitin 2003 në Mbretërinë e Arabisë Saudite, ishte i pamundur të sigurohej për shkak të kohës së hershme të këtyre ngjarjeve, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, për të ardhurat e pretenduara nga emigracioni në shtetin grek, nuk rezultoi të ketë bërë ndonjë përpjekje konkrete për të siguruar informacion për punëdhënësin/it, si dhe për nivelin e të ardhurave të krijuara.

20.21 Gjithashtu, për sa i takon justifikimit të të ardhurave në vlerën prej 12000 eurosh, subjekti nuk arriti t’i vërtetojë trupit gjykues përpjekjet për të siguruar, qoftë nga administrata tatimore apo edhe nga vetë shoqëria {***}ShPK, informacion të drejtpërdrejtë për përmbushjen prej saj të detyrimit për pagimin e tatimit në burim lidhur me këto të ardhura. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i vërtetojë Kolegjit se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave objekt gjykimi sipas këtij shkak ankimor, është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër, subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

20.22 Në lidhje me këtë shkak të ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues arrin në konkluzionin se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën prej 3.000.000 lekësh (duke përfshirë vlerën prej 12.000 eurosh), të deklaruara si burim për krijimin e pasurive tokë arë dhe godinë banimi, me vendndodhje Yzberisht, Tiranë, nuk u provuan nga subjekti se përmbushin kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasuritë e sipërcituara, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për t’i justifikuar ato.

- 21.** *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi mungesën e verifikimit të ligjshmërisë së shumës prej 19.975,23 USD, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006, si e ardhur nga puna e bashkëshortit në Arabinë Saudite, trupi gjykues, pasi shqyrtoi vendimin e Komisionit,*

¹⁷ Neni 35, pika 2 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, parashikon:

“Paguesi i këtyre shumave duhet të nxjerrë pagesat e përfitimeve dhe mbajtjen në burim të tatimeve dhe t’ua vërë në dispozicion organeve tatimore, si dhe personit, për të cilin është bërë pagesa, regjistrimet përkatëse”.

dokumentacionin e hetuar prej tij gjatë hetimit administrativ, dhe pasi vlerësoi pretendimet e Komisionerit Publik dhe kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton se:

21.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë (*vetting*) dhe atë të deklarimit periodik/vjetor për vitin 2006 ka deklaruar të ardhura në vlerën prej 20.000 USD, nga puna e bashkëshortit si inxhinier topograf pranë firmës {***} s.p.a. në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

21.2 Lidhur me këto të ardhura, Komisioni shprehet në vendimin e tij se *ka hetuar në lidhje me të ardhurat e deklaruara në deklaratën e pasurisë për vitin 2006, të krijuara nga puna e bashkëshortit të subjektit si inxhinier pranë shoqërisë {***} s.p.a. në Arabinë Saudite, në vlerën 18970 (tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) USD dhe ka konstatuar se në emër e për llogari të subjektit të rivlerësimit, në vitin 2006 janë kryer dy transferta në llogarinë e tij në monedhën USD, në “Procredit Bank”, përkatësisht në vlerën 10.000 USD (9982 USD) më datë 28.04.2006 dhe 10.000 USD (9982 USD) më datë 13.07.2006, transferta këto për të cilat në përfundim të hetimeve pranë “ProCredit Bank” është konfirmuar urdhëruesi i tyre. Komisioni ka konkluduar se deklarimi i subjektit lidhur me këto të ardhura është në përputhje me përgjigjen e dhënë nga “ProCredit Bank”.*

21.3 Komisioneri Publik në ankimin e tij pretendon se Komisioni nuk ka hetuar lidhur me saktësinë e deklarimit të subjektit të rivlerësimit të kryer në vitin 2006, duke pretenduar se në këtë rast subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, pasi në deklaratën vjetore për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 18970 USD, si të ardhur të krijuar nga puna e bashkëshortit si inxhinier pranë Shoqërisë {***} në Mbretërinë e Arabisë Saudite, por nga verifikimi i llogarisë bankare, shuma e përfituar nga këto transferta është 19975.23 USD.

21.4 Lidhur me këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, u shpreh se ndryshe nga sa parashtron Komisioneri Publik, si në deklaratën *vetting*, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2006, nuk ka pasaktësi në lidhje me vlerën e së ardhurës së deklaruar nga puna e bashkëshortit të saj në vitin 2006. Ajo shprehet se në të dyja deklaratat është deklaruar si e ardhur shuma 20.000 USD (gjatë dy transfertave të kryera banka ka mbajtur komision afërsisht 24,77 USD dhe shuma e mbërritur në bankë është 19975,23 USD). Shuma 18970 USD, që përmend Komisioneri, është gjendja në llogarinë bankare më datë 31.12.2006.

21.5 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi pasaktësinë në deklarimin e shumës së të ardhurave nga puna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë vitit 2006, trupi gjykues konstaton se në deklarimin periodik/vjetor të pasurive dhe interesave privatë, subjekti në rubrikën “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, ka deklaruar shprehimisht: “Llogari rrjedhëse në USD në bankën ProCredit. Çelur në muajin prill 2006” (në këtë llogari janë transferuar me transfertë ndërkombëtare të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti si inxhinier topograf pranë {***} në Arabi Saudite) dhe në kolonën ngjitur, në krah të këtij përshkrimi është deklaruar vlera prej 18970 USD. Ndërsa në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shprehimisht: “Të ardhura nga puna e bashkëshortit si inxhinier topograf pranë firmës {***} në

Arabi Saudite” dhe në kolonën ngjitur, në krah të këtij përshkrimi është deklaruar vlera 20.000 USD, e shprehur edhe me fjalë.

21.6 Nga shqyrtimi i gjendjes së llogarisë/lëvizjet në USD, të mbajtesit të saj, shtetases Antoneta Sevdari, me nr. {***}, të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 03.01.2018, të bankës ProCredit u konstatuan: (i) transfertë ndërkombëtare bankare hyrëse në datën 28.04.2006 me vlerë krediti 9982,97 USD; (ii) tërheqje *cash* në datën 09.05.2006, me vlerë 1000 USD; (iii) transfertë ndërkombëtare bankare hyrëse në datën 13.07.2006, me vlerë krediti 9987,26 USD; (iv) gjendje llogarie në datën 31.12.2006, në vlerën 18970,23 USD.

21.7 Në analizë të sa më sipër, vlerësohet se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në raport me vlerën e të ardhurave të krijuara nga puna si inxhinier pranë shoqërisë {***} s.p.a. në Mbretërinë e Arabisë Saudite e personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit), është i saktë, vlerësuar kjo në raport me vlerën e transfertave ndërkombëtare bankare në hyrje. Pasaktësia e pretenduar nga Komisioneri Publik në lidhje me vlerën e deklaruar prej 18970 USD nuk qëndron, pasi ky deklarim i subjektit nuk i referohet vlerës së të ardhurave (shumës së 2 transfertave ndërkombëtare, bankare hyrëse), por i referohet gjendjes së llogarisë në datën 31.12.2006¹⁸, vlerë kjo e cila vjen si rezultante e lëvizjeve hyrëse dhe dalëse në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, me kohëzgjatje nga data 1 janar 2006 – 31 dhjetor 2006, dhe që në rastin objekt shqyrtimi paraqitet si diferencë e shumës së dy transfertave ndërkombëtare, bankare në hyrje dhe vlerës prej 1000 USD, të tërhequr nga subjekti në arkë, si më sipër evidentuar.

21.8 Për rrjedhojë, sa i takon saktësisë së deklarimit të subjektit lidhur me të ardhurat e deklaruara nga puna e bashkëshortit në Mbretërinë e Arabisë Saudite, trupi gjykues arrin në konkluzionin që deklarimi i subjektit është në përputhje me parashikimin e nenit 4¹⁹ të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, dhe pretendimi i ankuesit për deklarim të pasaktë nuk qëndron.

21.9 Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) në vitin 2006, Komisioneri Publik pretendon gjithashtu se Komisioni nuk ka verifikuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, duke u mjaftuar vetëm me deklarimin e të ardhurave dhe faktin e konfirmimit të urdhëruesit të transfertës bankare, dhe nuk ka administruar asnjë dokumentacion provues lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, madje as subjekti nuk ka arritur ta provojë këtë fakt. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik pretendon që në këto kushte, shuma prej 19970,23 USD nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁸ Konfirmuar ky fakt edhe nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e dhëna për pyetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ, më datë 26.02.2018.

¹⁹ Neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, (sipas ndryshimeve deri më 31 mars të vitit 2007), në pikat “d” dhe “e” të tij parashikon:

“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, **gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës** të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...]

d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj; [...]

e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale”.

21.10 Lidhur me këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi se këto të ardhura provohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm që janë të ardhura të realizuara nga personi i lidhur, si rezultat i punës. Në kundërshtim me sa pretendon Komisioneri Publik, subjekti deklaroi se për efekt të të provuarit të burimit të ligjshëm të këtyre të ardhurave, janë administruar një sërë aktesh shkresore. Sa i takon çështjes së pagesës së tatimeve lidhur me këto të ardhura, subjekti pretendoi se në kohën e krijimit të tyre detyrimi i plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës integrale, si dhe mënyra e pagesës së tatimit mbi të ardhurën e fituar jashtë Shqipërisë nuk ka qenë e përcaktuar me ligj dhe, për rrjedhojë, personi i lidhur nuk ka pasur detyrim të deklarojë pranë organeve tatimore shqiptare të ardhurën e marrë nga punësimi në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

21.11 Subjekti në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit, të datës 16.04.2018, ka deklaruar që tatimi për këto të ardhura është mbajtur në burim në vendin e krijimit (Mbretërinë e Arabisë Saudite) dhe, sa i takon shumës së mbajtur si tatim në burim në vendin e krijimit dhe dokumentacionit provues lidhur me pagimin e tij, ka pretenduar pamundësi për të shpjeguar dhe dokumentuar këtë fakt, pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim. Gjithashtu, subjekti parashtroi që mungesa e detyrimit për të paraqitur deklaratën integrale para organeve tatimore bëri të panevojshëm dokumentimin e pagimit të tatimit në vendin e origjinës së burimit.

21.12 Në shqyrtim të pretendimeve të Komisionerit Publik dhe kundërshtimeve të subjektit të rivlerësimit për këtë shkak, trupi gjykues konstaton se në referim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjekti duhet të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, por edhe të të ardhurave. Standardi i vendosur nga kjo dispozitë për përcaktimin e ligjshmërisë së të ardhurave kërkon që të ardhurat të jenë krijuar nga burime të ligjshme, të jenë deklaruar dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse.

21.13 Në analizë të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit të administruar gjatë këtij procesi, rezulton që në pyetësorin e dërguar subjektit me anë të *e-mail*-it të datës 20.02.2018, Komisioni i ka kërkuar subjektit vënien në dispozicion të kontratës së punës që ka shërbyer për krijimin e këtyre të ardhurave, si dhe të urdhëruesit të transfertave bankare. Në vijim, në pyetësorin e datës 16.04.2018, Komisioni ndër të tjera ka kërkuar nga subjekti specifikimin e vlerës së tatimit të paguar, si dhe shtetin në të cilin është paguar ky tatim, duke kërkuar edhe depozitimin e dokumentacionit provues përkatës.

21.14 Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, në përgjigjet e saj ka deklaruar që bashkëshorti i saj nuk është në dijeni të vlerës së tatimit të paguar për të ardhurat e krijuara në Mbretërinë e Arabisë Saudite, por konfirmon faktin që tatimi është paguar në Mbretërinë e Arabisë Saudite nga punëdhënësi i tij, në burim. Sa i takon kontratës së punës, subjekti është përgjigjur që nuk ka mundur ta gjejë atë, por për efekt të të provuarit të marrëdhënies së punësimit, ka përcjellë dokumentacion që provon qëndrimin e bashkëshortit në Arabinë Saudite në periudhën e krijimit të të ardhurave të deklaruara, si dhe natyrën e shërbimit të ofruar.

21.15 Pavarësisht mungesës së kontratës së shërbimit mes personit të lidhur dhe shoqërisë {***} s.p.a., nga shqyrtimi i dokumentacionit justifikues të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, sipas nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i shpjegimeve

të dhëna nga subjekti në pyetësorët e Komisionit, si dhe para Kolegjit, i deklaratës periodike/vjetore të vitit 2006 dhe asaj *vetting*, trupi gjykues, arrin deri në nivelin e besueshmërisë (por jo atë të bindjes) për sa i takon faktit të angazhimit të bashkëshortit të subjektit në ofrimin e shërbimeve gjeodezike për kompaninë {***} s.p.a., degës së saj në Mbretërinë e Arabisë Saudite, në periudhën 27.02.2006-24.07.2006.

21.16 Trupi gjykues nga dokumentacioni i administruar nuk arriti nivelin e bindjes as për faktin e pretenduar, se z. F. A. i ka kryer dy transfertat bankare nga territori i Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe se në urdhërimin e tyre ky i fundit kishte vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë pranë së cilës pretendohet se kishte ofruar shërbimet e tij z. A. S.

21.17 Ndërkohë, sa i takon momentit tjetër të vlerësimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, që lidhet me përmbushjen e detyrimeve tatimore përkatëse, trupi gjykues konstaton se lidhur me këtë fakt nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues, konstatim ky i pohuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit.

21.18 Ndodhur përpara pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në Republikën e Shqipërisë nuk është paguar tatim lidhur me të ardhurat e krijuara në Mbretërinë e Arabisë Saudite, duke qenë se në vitin 2006 nuk parashikohej një detyrim i tillë, trupi gjykues merr në analizë legjislationin tatimor mbi të ardhurat personale, sipas parashikimeve në fuqi në kohën e krijimit të të ardhurave objekt shqyrtimi, dhe në vijim të kësaj analize juridike çmon se, referuar nenit 3 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe pikës 1.3 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit vlerësohet si “rezident tatimor shqiptar”, pasi përmbush jo vetëm kriterin e vendbanimit të përhershëm sipas nenit 12 të Kodit Civil, por edhe atë të kohëzgjatjes së qëndrimit në Shqipëri për më shumë se 183 ditë gjatë vitit tatimor objekt shqyrtimi (viti 2006)²⁰. Në këtë kuptim, personi i lidhur vlerësohet se ka qenë subjekt detyrimesh tatimore mbi të ardhurat personale, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998²¹, me të vetmen rezervë rastet kur janë të zbatueshme marrëveshje ndërkombëtare për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe shmangien e evazionit fiskal, që në rastin objekt gjykimi, sipas verifikimeve në faqen zyrtare të organit tatimor, nuk rezulton të jetë nënshkruar një marrëveshje e kësaj natyre mes Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite²².

21.19 Për rrjedhojë, sipas pikës 2.6.4 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, për të ardhurat e realizuara nga burime jashtë Shqipërisë, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, në cilësinë e përfituesit të të ardhurave, ka pasur detyrimin t’i deklaronte ato dhe të paguante në organin tatimor, tatimin në masën 10% të të ardhurave të realizuara. Ky tatim i nënshtrohet reduktimit, deri në masën e detyrimit tatimor, sikur këto të ardhura të ishin krijuar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me dispozitën e nenit 37 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998²³, për kreditimin e tatimit të huaj, në rastin që për të ardhurat e realizuara

²⁰ Referuar të dhënave të pasaportës së personit të lidhur për vitin 2006, qëndrimi në Mbretërinë e Arabisë Saudite shënohet nga data 27.02.2006-24.07.2006, për rrjedhojë personi i lidhur ka pasur 219 ditë qëndrimi në Shqipëri gjatë vitit tatimor 2006.

²¹ Neni 7, pika 1 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, parashikon se individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu. Gjithashtu, pika 2.2 e udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, detajon konceptin e burimit të të ardhurave në burime brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

²² Shih <https://www.tatime.gov.al/c/6/125/marveshje-nderkombetare>.

²³ Shih edhe pikën 7.1 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet tatim i pagueshëm sipas vendit të huaj dhe pagesa e këtij tatimi provohet me dokument justifikues.

21.20 Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e realizuara nga puna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Mbretërinë e Arabisë Saudite në vitin 2006, do mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, vetëm nëse për to provohet: (i) pagesa e tatimit në vendin e burimit dhe, në rastet që shkalla tatimore për këto të ardhura në vendin e burimit është më e vogël se 10%, edhe pagesa e tatimit në Republikën e Shqipërisë, deri në masën e shkallës tatimore sikur këto të ardhura të ishin realizuar në Shqipëri; ose në mënyrë alternative (ii) pagesa e tatimit për vlerën e plotë të të ardhurave të deklaruara në Republikën e Shqipërisë në shkallën tatimore 10% mbi të ardhurat bruto, nëse sipas legjislacionit në vendin e origjinës nuk parashikohet tatim për llojin e të ardhurës sipas klasifikimit përkatës të legjislacionit vendas ose edhe në rastin e një parashikimi të tillë, pagesa nuk provohet pranë organeve tatimore shqiptare me dokumentacionin përkatës justifikues.

21.21 Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, sikundër është konstatuar dhe në paragrafët pararendës, subjekti i rivlerësimit nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion që provon pagesën e tatimit mbi këto të ardhura në Republikën e Shqipërisë dhe, për më tepër, ka pretenduar para Kolegjit se në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave, nuk ka qenë i përcaktuar me ligj detyrimi i plotësisht dhe dorëzimit të deklaratës integrale, si dhe mënyra e pagesës së tatimit mbi të ardhurën e fituar jashtë Shqipërisë dhe, për rrjedhojë, personi i lidhur nuk ka pasur detyrim të deklarojë pranë organeve tatimore shqiptare të ardhurën e marrë nga punësimi në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

21.22 Në shqyrtimin e këtij pretendimi, referuar analizës së kuadrit ligjor në fuqi lidhur me tatimin mbi të ardhurat personale, në kohën e krijimit të tyre, trupi gjykues vlerëson se detyrimi i tatimpaguesve rezidentë për t'iu nënshtruar tatimit mbi të ardhurat, sipas burimeve të tyre, dhe për secilin prej tyre (brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë) nuk lidhet me momentin e lindjes së detyrimit për deklarimin vjetor të të ardhurave të individëve. Detyrimi për deklarim sipas deklaratës integrale, parashikuar në nenin 13 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998²⁴, i referohej pikërisht detyrimit për deklarimin vjetor të të ardhurave të krijuara, detyrim i cili u bë efektiv me

²⁴ Neni 13, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar me ligjin nr. 9326, datë 06.12.2004, parashikojnë:

"[...] 3. Në përputhje me fazat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, çdo individ që realizon të ardhura, pavarësisht nëse këto të ardhura janë tatuar apo janë ose jo të tatueshme, duhet të paraqesë në organin tatimor përkatës deklaratën tatimore integrale për të ardhurat personale, të realizuara nga çdo burim, jo më vonë se 28 shkurti i vitit pasardhës. Modeli i deklaratës integrale të të ardhurave personale do të përcaktohet në një udhëzim të posaçëm të ministrit të Financave.

4. Detyrimi për të deklaruar, sipas pikës 2 të këtij neni, zbatohet në fazat e mëposhtme:

a) në fazën e parë, për të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2005 e në vijim, pronarët dhe administratorët e shoqërive (tregtare), personat fizikë, të regjistruar si subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore dhe drejtuesit apo pronarët e fondacioneve ose organizatave jofitimprurëse duhet të dorëzojnë deklaratën integrale;

b) në fazën e dytë, për të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2006 e në vijim, të gjithë punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit të shërbimit civil duhet të dorëzojnë deklaratën integrale;

c) në fazën e tretë, për të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2007 e në vijim, të gjithë të punësuarit e institucioneve buxhetore, të ndërmarrjeve shtetërore apo private, të fondacioneve dhe të vetëpunësuarit ose të punësuarit në subjektet e biznesit të vogël, duhet të dorëzojnë deklaratën integrale".

ndryshimet e ligjit nr. 8438, në vitin 2012. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit, sipas të cilit, për sa kohë nuk përcaktohej me ligj detyrimi i plotësimit të deklaratës integrale²⁵, nuk ekzistonte as detyrimi për të deklaruar të ardhurën e krijuar nga burimet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është i pabazuar në ligj, pasi mbështetet në interpretimin e gabuar që i bëhet kuadrit ligjor përkatës, për sa kohë një zbatim i tillë i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.2003, do të çonte në shmangien e detyrimit ligjor nga subjektet tatimpaguese për pagimin e detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat e krijuara jashtë Shqipërie.

21.23 Për më tepër, referuar pikës 2.6.4 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, detyrimi për deklarim të të ardhurave nga burime jashtë Shqipërisë dukshëm parashikohet si një detyrim i pavarur nga detyrimi për plotësimin e deklaratës integrale në atë kohë, apo dhe deklaratës individuale vjetore të të ardhurave në ditët e sotme, për sa kohë përfituesi i të ardhurave është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë tatimin përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa, krahasuar me momentin e deklarimit sipas deklaratës integrale [në kohën kur kjo ishte në fuqi] apo deklaratës individuale vjetore të të ardhurave, sipas parashikimeve aktuale në fuqi, që përcaktohet si afat në raport me vitin pasardhës fiskal. Gjithashtu, përmbajtja e pikës 2.6.4 e udhëzimit të sipërcituar përbën edhe parashikimin nënligjor mbi mënyrën e pagesës së tatimit mbi të ardhurat e krijuara për këtë burim të ardhurash dhe, për pasojë, është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mënyra e pagesës së tatimit mbi të ardhurën e fituar jashtë Shqipërisë nuk ka qenë e rregulluar në legjislacionin e kohës.

21.24 Sa i takon pretendimit të subjektit, gjatë konkluzioneve përfundimtare, se referenca e Komisionerit Publik në deklaratën e tatimit mbi të ardhura të tjera, është e referencë e gabuar, duke qenë se kjo deklaratë lidhet me të ardhurat e tjera që nuk identifikohen në mënyrë të shprehur në ligj dhe të cilat trajtohen në pikën 2.3.9 të udhëzimit të ministrit të Financave, trupi gjykues çmon se, pavarësisht faktit që deklarata në fjalë u referohet disa kategorive të burimeve të të ardhurave, të cilat përfshihen në gamën e përcaktimeve të pikës 2.3.9 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, që detajon urdhërimin e nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, objekti i veprimtarisë së të cilit shtrihet në burimet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ajo përfshin në mënyrë të shprehur edhe të ardhurat me burim jashtë territorit të saj (vlerësuar këto si një kategori e vetme, pavarësisht llojit të së ardhurës, klasifikimi i të cilave është kompetencë e vendeve të burimit). Një zgjidhje e tillë teknike nga ana e organit përgjegjës për përfshirjen në të njëjtën deklaratë të të ardhurave me burime brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk cenon përcaktimin e mënyrës së deklarimit dhe të pagesës për këto të ardhura dhe aq më pak nuk shuan detyrimin e tatimpaguesve për zbatimin e tij.

21.25 Gjithashtu, në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit, duke qenë se e ardhura realizohet nga punësimi dhe pagesa mbahet në burim nga punëdhënësi, ajo është shprehimisht e përjashtuar nga deklarimi sipas deklaratës së tatimit mbi të ardhura të tjera, referuar

²⁵ Duke qenë se me miratimin e ligjit ndryshues për tatimin mbi të ardhurat nr. 9458, datë 21.12.2005, pikat 3 dhe 4 të nenit 13 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, si më sipërcituar u shfuqizuan.

edhe shënimit shpjegues në fund të kësaj deklarate, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim është i pabazuar në ligj, për sa kohë shënimi shpjegues u referohet vetëm të ardhurave të krijuara nga burime brenda Republikës së Shqipërisë, për të cilat sipas neneve 10 dhe 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, përcaktohet agjenti tatimor. Për rrjedhojë, në këtë kategori nuk përfshihen as të ardhurat nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sikundër dhe ato me burime brenda territorit të saj, të cilat nuk përfshihen në objektin e neneve 10 dhe 33 të ligjit të sipërcituar.

21.26 Në konkluzion të sa më sipër, sa i takon detyrimit për t'iu nënshtruar dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, lidhur me të ardhurat e krijuara nga burime jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se, pavarësisht pagesës ose jo të tatimit mbi të ardhurat realizuar në Mbretërinë e Arabisë Saudite, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit kishte detyrimin për të deklaruar pranë organeve tatimore shqiptare të ardhurat bruto të realizuara dhe t'ia nënshtronte ato tatimit në shkallën tatimore 10%, duke u bërë njëkohësisht edhe subjekt kreditimi për tatimin e paguar në Mbretërinë e Arabisë Saudite deri në vlerën e shkallës tatimore 10%, nëse provonte me dokumentacion vlerën e tatimit të paguar. Në këtë kuptim, trupi gjykues i çmon të pabazuara në ligj pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mungesë të detyrimit ligjor për pagesën e tatimit lidhur me të ardhurat objekt shqyrtimi në Republikën e Shqipërisë.

21.27 Sa i takon pagimit të tatimit lidhur me këto të ardhura në vendin e burimit (Arabi Saudite), pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, se bashkëshorti i saj, duke mos pasur në 2006-ën detyrimin për të deklaruar llojin e të ardhurës dhe shumën e tatimit në burim, të mbajtur për këtë të ardhur në Arabi Saudite, aktualisht nuk ka mundësi të shpjegojë dhe të paraqesë dokumentacion që të specifikojë shumën konkrete të tatimit të paguar në 2006-ën nga punëdhënësi i tij, çmohet nga trupi gjykues në vijim të analizës së kuadrit ligjor si më sipër, si pretendim abuziv. Për më tepër, trupi gjykues çmon të nevojshme të evidentojë se të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nga puna e tij në Mbretërinë e Arabisë Saudite, janë transferuar në një llogari rrjedhëse të hapur pranë ProCredit Bank, në datën 10.04.2006, në emër të subjektit të rivlerësimit. Ky fakt, në vlerësim të trupit gjykues, do të duhej të shtonte kujdesin e subjektit të rivlerësimit për të garantuar përmbushjen e çdo detyrimi ligjor të bashkëshortit të saj në raport me detyrimet tatimore mbi këto të ardhura, jo vetëm për shkak të nivelit të njohurive ligjore në këtë fushë, por edhe në kuptim të domosdoshmërisë për të qartësuar pozitën e saj në raport me zbatimin e ligjit në lidhje me këto të ardhura, të cilat edhe pse jo të realizuara prej saj, zyrtarisht figuronin të depozituara në llogarinë e saj personale nga viti 2006 deri në vitin 2007, kur kaluan në llogari rrjedhëse dyemërore, të sajën dhe të bashkëshortit të saj, deri në mbylljen e llogarisë dhe pakësimin e gjendjes së likuiditetit, me vlerën totale prej 19.796,9 USD, më datë 10.09.2011, vetëm disa ditë përpara blerjes nga bashkëshorti, z. A.S., të pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament”, me sipërfaqe 101 m², me nr. pasurie {***}, zonë kadastrale nr. {***} dhe adresë: Rruga {***}, Tiranë, me vlerë 97.500 euro, sipas kontratës noteriale të shitblerjes me nr. 3183 rep. dhe nr. 1908 kol., datë 19.09.2011, të noteres V. S.. Ky fakt e çon trupin gjykues në konkluzionin se shuma e sipërcituar është përdorur si burim krijimi (blerjen) i kësaj pasurie të paluajtshme.

21.28 Dokumentimi i përmbushjes së detyrimeve ligjore lidhur me këto të ardhura, do duhej të përbënte për subjektin domosdoshmëri, sidomos gjatë procesit të rivlerësimit, dhe përpjekjet e saj në këtë drejtim duhet të ishin të plota, reale dhe të gjithanshme, ndërkohë që në vlerësim të trupit gjykues ato mbetën në nivel pretendimi, për sa kohë përpjekjet për komunikime elektronike me degën e kompanisë {***} s.p.a. në Mbretërinë e Arabisë Saudite nuk u provuan përpara trupit gjykues, sikundër dhe nuk rezultoi të ishte bërë asnjë përpjekje tjetër e çfarëdolloj forme, në drejtim të vërtetimit të faktit të pagimit të detyrimeve tatimore nga kjo shoqëri në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

21.29 Në përfundim, lidhur me këtë shkak të ankimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, për të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në vlerën e 20000 USD, nga shërbimet e tij në Mbretërinë e Arabisë Saudite gjatë vitit 2006, nuk u arrit të provohet se për këto të ardhura janë përmbushur detyrimet tatimore përkatëse dhe, për rrjedhojë, ato nuk përmbushin kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi²⁶. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit edhe për këtë pasuri, fillimisht në formën e likuiditetit dhe më pas e transformuar në pasuri të paluajtshme, ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin që kjo e ardhur, në momentin e krijimit të saj në vitin 2006, është depozituar në një llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që ajo ushtronte funksionin e prokurores dhe ishte përgjegjëse për ndjekjen e veprave penale në lidhje me taksat dhe tatimet, të parashikuara në Seksionin VI të Kreut III të pjesës së posaçme të Kodit Penal, e bën të papranueshëm mosprovimin prej saj të pagimit të tatimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, lidhur me këto të ardhura të deklaruara. Kjo sjellje vlerësohet se cenon besueshmërinë e subjektit për të kërkuar përpikëri në respektimin e ligjit, në mënyrë të veçantë në fushën e taksave dhe tatimeve dhe, për rrjedhojë, edhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për këtë arsye, trupi gjykues arrin në përfundimin që një situatë e tillë ndikon në rezultatin përfundimtar të rivlerësimit të subjektit në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kritereve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

22. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimit për vitin 2010, sa i takon pagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, person fizik tatimpagues, në shumën 3.171.510 lekë, e cila ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë e paluajtshme të llojit "apartament", me sipërfaqe 101 m², me nr. pasurie {***}, zonë kadastrale nr. {***} dhe adresë: Rruga {***}, Tiranë, trupi gjykues konstaton:*

22.1 Komisioni në vendimin e tij, sa u takon të ardhurave të krijuara nga aktiviteti ekonomik i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë vitit 2010, është shprehur në kuadër të vlerësimit dhe kontrollit të pasurisë (apartament me sipërfaqe 101 m² në Rrugën {***}, Tiranë) për të cilën këto të ardhura kanë shërbyer si burim krijimi, se ka hetuar në lidhje me aftësinë paguese për krijimin

²⁶ Të njëjtin qëndrim në lidhje me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave ka mbajtur edhe ILDKPKI-ja në aktin e saj të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, referuar f. 14 të Aktit të Kontrollit.

e kësaj pasurie dhe ka konkluduar se nga analiza ekonomike e kryer prej tij lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe nga komunikimi me subjektin e rivlerësimit mbi saktësimin e të ardhurave dhe burimit të tyre të ligjshëm, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

22.2 Në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, Komisioneri Publik pretendon se konkluzioni i Komisionit është rrjedhojë e një hetimi të mangët, duke qenë se dokumentacioni i përcjellë për këtë qëllim nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë²⁷ (në vijim “DRT Tiranë”), në kuadër të hetimit të kryer lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit për vitin 2010, në shumën 3 171.510 lekë, është kontradiktor.

22.3 Gjithashtu, ankuesi pretendon se vendimi i Komisionit vjen si rrjedhojë e mosvlerësimit të drejtë të kësaj çështjeje, duke qenë se ai ka marrë për bazë shkresën e DRT Tiranë, në të cilën referohet fitimi neto i vetëdeklaruar në pasqyrat financiare për vitin 2010, dorëzuar nga subjekti tatimpagues në vitin 2016, dhe jo shkresën e administruar nga ILDKPKI-ja, ku për të njëjtin subjekt tatimpagues referohet se nuk ka të dhëna në sistem elektronik të organit tatimor.

22.4 Subjekti i rivlerësimit sqaroi se informacioni i përcjellë nga organet tatimore nuk është kontradiktor, përkundrazi konfirmon vlerën e fitimit, deklarin dhe pagesën në kohë të tatimit mbi këtë fitim të realizuar për vitin fiskal 2010 dhe madje mungesa e informacionit në sistemin elektronik të administratës tatimore për fitimin e realizuar për këtë vit nga personi fizik tatimpagues, u provua gjatë hetimit administrativ në Komision që është rezultat i ngecjes në sistemin e deklarimit *online* të formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit për biznesin e vogël, konfirmuar ky fakt edhe nga vetë administrata tatimore në korrespondencën e saj me Komisionin.

22.5 Në shqyrtim të pretendimit të ngritur në ankim nga Komisioneri Publik, trupi gjykues konstaton se nga vlerësimi i akteve të dosjes gjyqësore rezulton se informacionet e përcjella në drejtim të ILDKPKI-së nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë konfirmojnë që në sistemin elektronik të tatimeve nuk ka të dhëna për vitin 2010 për shtetasin A. H. S., të regjistruar si person fizik me NIPT {***}, ndërkohë informacioni i përcjellë personit të lidhur në vijim të kërkesës së tij, nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit²⁸ pranë DRT Tiranë, referon se sipas formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit fitimit, ndër të tjera edhe për vitin 2010, fitimi neto është 3.506.533 lekë dhe fitimi pas tatimit është 3.171.510 lekë. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, është administruar edhe shkresa me nr. {***}, datë 25.04.2018, e përcjellë nga Drejtoria e Analizës dhe Informatikës pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë, sipas së cilës deklarohet se për vitin 2010 të ardhurat e deklaruara janë 7.278.320 lekë, fitimi para tatimit është 3.506.533 lekë dhe fitimi neto 3.170.699 lekë. Të dhënat referohen si të nxjerra nga pasqyrat financiare të dorëzuara në arshivë më datë 26.01.2016, me nr. {***} prot., dhe të konfirmuara nga informatika (taxcrm).

²⁷ Me dokumentacionin e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT), Komisioneri Publik i referohet:
1. shkresës kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 22.11.2016, të DRTT ndaj kërkesës së z. A. S.;

2. shkresave nr. {***} prot., datë 30.8.2017, dhe nr. {***} prot., datë 31.8.2017, të DRTT, drejtuar ILDKPKI-së, për të njëjtin subjekt tatimpagues (NIPT {***});

3. shkresës nr. {***} prot., datë 25.4.2018, të DRTT, drejtuar Komisionit.

²⁸ Përcjellë bashkëlidhur shkresës së DRTT nr. {***} Prot., datë 22.11.2016.

22.6 Në analizë të akteve të sipërcituara, trupi gjykues vëren se nga drejtori të ndryshme, të gjitha pjesë e strukturës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, janë përcjellë informacione me përmbajtje të ndryshme, por jo kontradiktore, pasi referenca që në sistemin elektronik të tatimeve për vitin 2010 nuk ka të dhëna, jo domosdoshmërisht nënkupton që për këtë subjekt nuk disponohet asnjë e dhënë pranë këtij institucioni tatimor. Duke vlerësuar konstatimin e mësipërm në dritën e dy akteve²⁹ bashkëlidhur shkresës nr. {***}, datë 25.04.2018, të Drejtorisë së Analizës dhe Informatikës, të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, me anë të së cilave vërtetohet (i) pagesa më datë 29.03.2011 e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël në vlerën prej 335.148 lek, sipas lëvizjeve në llogarinë bankare të personit të lidhur pranë Raiffeisen Bank dhe (ii) deklarimi *online*, më datë 29.03.2011, në sistemin elektronik të tatimeve, sipas një printimi nga adresa elektronike e znj. D. F.³⁰, me titull “Deklaratë e ngecur në sistemin on_line me nvd {***}”, i cili nga shqyrtimi i të dhënave të përmbajtjes i referohet subjektit tatimpagues me NIPT {***} dhe datës 29.03.2011, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni ka vepruar drejt kur ka marrë parasysh të dhënat e pasqyrave financiare të dorëzuara në arshivën e organit tatimor nga personi i lidhur në vitin 2016, të konfirmuara nga administrata tatimore me komunikimin e saj të datës 25.04.2018, dhe jo shkresën e administruar nga ILDKPKI-ja të datës 31.08.2017. Kjo vendimmarrje e Komisionit bazohet në fakte të provuara me dokumentacion të përcjellë nga vetë DRT Tiranë dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e personit të lidhur nga aktiviteti i tij ekonomik për vitin 2010 vlerësohen si të ardhura të deklaruara rregullisht³¹ nga subjekti tatimpagues në mars të vitit 2011, për të cilat është paguar edhe tatimi përkatës, i përcaktuar në bazë të fitimit të tatueshëm për periudhën në fjalë, sipas bilancit të hartuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare³².

22.7 Në konkluzion të sa më sipër, pretendimi i Komisionerit Publik për hetim jo të plotë në drejtim të verifikimit të vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramit për vitin 2010, sa i takon pagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, person fizik tatimpagues, në shumën prej 3.171.510 lekë, gjendet i pabazuar në prova dhe, pavarësisht nga sa pretendon ankuesi, vlerësimi i këtyre të ardhurave nga Komisioni është rezultat i një hetimi të plotë, të kryer në bazë të parashikimeve ligjore në fuqi dhe mbështetet në provat e administruara në fashikullin gjyqësor. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, person fizik tatimpagues, në shumën 3.171.510 lekë, të deklaruara si të realizuara nga aktiviteti ekonomik për vitin 2010, përmbushin kriteret e parashikuara nga Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, për t’u

²⁹ Konstatohet se vula në *statement-in* e bankës Raiffeisen mban datën 26.01.2016, të njëjtën datë me protokollimin e pasqyrave financiare pranë DRT Tiranë, çka lë të kuptohet që subjekti i ka dorëzuar pasqyrat financiare pranë organeve tatimore për efekt të të provuarit të pagesës së detyrimeve përkatëse tatimore, fakt që është konfirmuar edhe nga sektori IT, sipas deklaratës së datës 29.03.2011.

³⁰ Me detyrë {***}.

³¹ Neni 29, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit” parashikon:

“1. Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe [...]

2. Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumën e përcaktuar sipas nenit 37 të këtij ligji dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme”.

³² Shih nenin 19 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

konsideruar të ardhura të ligjshme dhe se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë, lidhur me to në deklaratën periodike për vitin 2010, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.

23. *Lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për hetim të paplotë në drejtim të verifikimit të ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga veprimtaria ekonomike e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në shumën 3.299.805 lekë, për vitin 2016 në raport me pagimin e detyrimeve tatimore përkatëse, trupi gjykues konstaton:*

23.1 Komisioni, referuar vendimit të tij, si dhe rezultateve të hetimit administrativ, nuk rezulton të jetë shprehur në mënyrë eksplicite lidhur me të ardhurat e deklaruara si fitim neto të personit të lidhur, të krijuara në kuadër të aktivitetit të tij tregtar gjatë vitit 2016.

23.2 Komisioneri Publik pretendon mangësi në hetimin e kryer, lidhur me këto të ardhura të deklaruara në vlerën prej 3.299.805 lekë, si të realizuara nga veprimtaria ekonomike e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë vitit 2016. Sipas tij, referuar përgjigjeve³³ kundërthënëse të administratës tatimore, të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, mbetet e paqartë nëse janë paguar detyrimet tatimore me qëllim legjitimimin e këtyre të ardhurave në kuptim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

23.3 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë shkak të ankimit, kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik, me argumentin se detyrimet e pashlyera për të cilat shprehet në shkresat e tij organi tatimor, nuk lidhen me tatimin mbi fitimin e realizuar për këtë vit, i cili referuar legjislacionit të zbatueshëm, për xhiron e realizuar deri në 5.000.000 lekë, ka qenë 0 lek, por me detyrime TVSh-je dhe detyrime lidhur me pagesën e kontributeve të detyrueshme për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në një vlerë relativisht të vogël, detyrime këto, të cilat janë shlyer në vazhdim. Në lidhje me pretendimin e ngritur në seancë gjyqësore të Komisionerit Publik për mungesë provash lidhur me pagesën e detyrimeve ndaj Drejtorisë së Taksave të Bashkisë Tiranë, subjekti sqaroi se pagesa e tyre është kryer dhe ky fakt provohet në dokumentacionin e administruar në fashikullin gjyqësor.

23.4 Në shqyrtimin e këtij shkak ankimor, nga analiza e dokumentacionit të dosjes gjyqësore, trupi gjykues vëren se lidhur me të ardhurat e krijuara nga personi i lidhur, në kuadër të aktivitetit të tij ekonomik për vitin 2016, në të gjitha shkresat e administruara gjatë hetimit administrativ, qoftë nga ana e ILDKPKI-së, si dhe nga ana e Komisionit, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë informon se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuadër të aktivitetit të tij tregtar si person fizik i regjistruar me NIPT {***}, gjatë vitit 2016 ka deklaruar të ardhura në vlerën 3.391.467 lekë dhe fitim të tatueshëm në vlerën 3.299.805 lekë.

23.5 Ndërkohë sa i takon gjendjes së detyrimeve tatimore të këtij subjekti, DRT Tiranë, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 03.08.2017, sqaron se detyrimi i subjektit në datën 02.08.2017 është 257.104 lekë, ndërsa me shkresën nr. {***} prot., të datës 30.8.2017 informon ILDKPKI-në se subjekti ka detyrime tatimore të palikuiduara në vlerën 283.132 lekë, vlerë kjo që përfaqëson

³³ *Më konkretisht: (i) shkresës nr. {***}, datë 25.04.2018, drejtuar KPK-së; (ii) shkresës nr. {***}, datë 30.08.2017, drejtuar ILDKPKI-së; (iii) shkresës nr. {***}, datë 31.08.2017, drejtuar ILDKPKI-së; (iv) shkresës nr. {***}, datë 12.01.2017, drejtuar A. S.*

detyrimin e subjektit tatimpagues në datën 17.08.2017. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dërguar nga institucioni tatimor³⁴, konstatoi se detyrimi në datën 02.08.2017 i takon TVSh-së së papaguar në vlerën prej 219.362 lekë (detyrim kryesor) dhe që pas aplikimit të gjobave dhe interesave përkatës detyrimi tatimor arrin vlerën prej 275.401 lekë, ndërsa detyrimi në datën 17.08.2017 paraqitet si shumatore e detyrimit të papaguar të TVSh-së që ekzistonte që në datën 02.08.2017 dhe një detyrimi të shtuar në vlerën e 7.152 lekë që u takon kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe atyre shëndetësore. Gjithashtu, referuar komunikimit më të fundit të DRT Tiranë, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 25.04.2018, drejtuar Komisionit, në të cilën ofrohet informacion mbi të dhënat tatimore lidhur me z. A.S., në vijim të verifikimit të të dhënave në DRT Tiranë, si dhe atyre të kontabilitetit ndër vite, ndër të tjera dhe për vitin 2016, nuk rezulton asnjë referencë lidhur me detyrime tatimore të papaguara për subjektin në fjalë.

23.6 Në përfundim të shqyrtimit të akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues arrin në përfundimin se informacioni i administruar gjatë hetimit nga ana e Komisionit, sa u takon të ardhurave të krijuara nga aktiviteti ekonomik i personit të lidhur, z. A.S., për vitin 2016, si person fizik me NIPT {***}, në vlerën e 3.299.805 lekë, që i takon fitimit neto, nuk paraqitet si kontradiktor, pasi në të gjitha shkresat referohen të njëjtat të dhëna. Sa u takon detyrimeve të papaguara, është e vërtetë që në dy shkresat e sipërcituara, të dërguara në adresë të ILDKPKI-së gjatë vitit 2017 janë dhënë dy vlera të ndryshme, megjithatë sikundër u sqarua më sipër rezulton që diferenca në vlerë i atribuohet një detyrimi të shtuar dhe ky fakt nuk përbën të dhënë në drejtim të pasaktësisë së të dhënave të përcjella nga administrata tatimore, si të dhëna kontradiktore, për të cilat Komisioni do të duhej të hetonte më tej.

23.7 Gjithashtu, detyrimi i papaguar i TVSh-së, i cili paraqitet si detyrim në kohë reale dhe i takon aktivitetit të subjektit tregtar në vitin 2017, vlerësohet se nuk cenon rezultatin financiar të vitit pararendës, bilanci i të cilit është përmbyllur në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi dhe është deklaruar rregullisht pranë autoriteteve përkatëse. Në lidhje me pretendimin e parashtruar në seancë gjyqësore nga Komisioneri Publik, sipas të cilit mbetet e paprovuar nëse janë paguar detyrimet ndaj Drejtorisë së Taksave të Bashkisë Tiranë, pasi në përgjigjet e Bashkisë Tiranë, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 30.10.2017, drejtuar Komisionit, konfirmohet se subjekti tatimpagues, z. A.S., nuk ka shlyer asnjë detyrim ndaj Bashkisë Tiranë, trupi gjykues pasi dëgjoi edhe subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë pretendim, si dhe shqyrtoi aktet e administruara në dosjen gjyqësore, arrin në konkluzionin se ky pretendim nuk mbështetet në prova, duke qenë se pagesa e këtyre detyrimeve ndaj Bashkisë Tiranë provohet të jetë shlyer më datë 15.11.2017, referuar lëvizjeve të llogarisë bankare nr. {***} të personit fizik A.S. pranë Bankës Kombëtare Tregtare, dokumentuar gjatë hetimit administrativ nga Komisioni.

23.8 Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i Komisionerit Publik për hetim jo të plotë në drejtim të verifikimit të vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramit për vitin 2016, për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, person fizik tatimpagues, në

³⁴ *Printim nga sistemi i detyrimeve në kohë reale me referencë {***} dhe datë 02.08.2017 dhe printim nga sistemi i detyrimeve në kohë reale me referencë {***} dhe datë 17.08.2017.*

shumën prej 3.299.805 lekësh, në raport me shlyerjen e detyrimeve tatimore përkatëse, gjendet i pabazuar në prova dhe se, pavarësisht nga sa pretendon ankuesi, vlerësimi i këtyre të ardhurave nga Komisioni është rezultat i një hetimi të plotë, të kryer në bazë të parashikimeve ligjore në fuqi dhe mbështetet në provat e administruara në fashikullin gjyqësor. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, person fizik tatimpagues, në shumën e 3.299.805 lekëve, të deklaruara si të realizuara nga aktiviteti ekonomik për vitin 2016, përmbushin kriteret e parashikuara nga Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme dhe se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë, lidhur me to, në deklaratën periodike për vitin 2016, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.

b) Kriteri i vlerësimit të aftësive profesionale

24. *Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik trajtohen në dy aspekte: së pari, mbi mungesën e hetimit nga Komisioni të denoncimeve të ardhura nga publiku lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, së dyti, për qëndrim jo të drejtë nga ana e Komisionit ndaj rezultateve të hetimit, sa i takon çështjes së referuar në raportin e vlerësimit të aftësive profesionale si Rasti 5, rast ky i cili referuar Komisionerit Publik do të duhet të vlerësohet edhe në konsideratë të denoncimeve të ardhura në adresë të subjektit të rivlerësimit, lidhur me aftësitë profesionale të subjektit.*

25. Në lidhje me adresimin e denoncimeve të publikut të depozituara në Komision, ky i fundit në vendimin e tij, është shprehur se në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 10 denoncime të depozituara pranë Komisionit. Pas hetimit të raportit të grupit të punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe denoncimeve, nuk u gjet asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurores, znj. Antoneta Sevdari.

25.1 Komisioneri Publik, lidhur me 10 denoncimet e publikut të depozituara në Komision, pretendoi në ankimin e tij se për disa prej tyre hetimi nga Komisioni ka munguar plotësisht, duke përmendur për ilustrim denoncimet e tre shtetasve, si dhe për katër raste të tjera, sipas Komisionerit Publik, edhe pse Komisioni ka kërkuar dokumentacion, në vendimin përfundimtar të tij nuk ka reflektuar asnjë trajtim dhe vlerësim lidhur me këto denoncime.

25.2 Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, lidhur me këtë pretendim, pasi i mori në analizë në parashtrimet e saj secilin prej denoncimeve, kundërshtoi Komisionerin Publik me argumentin se hetimi për secilin prej tyre që mund të ishin objekt vlerësimi për Komisionin, sipas kornizave të ligjit nr. 84/2016, kishte qenë i plotë dhe se konkluzioni i arritur nga Komisioni, se në asnjë prej këtyre denoncimeve nuk u gjet asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurores, kishte qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj.

25.3 Në marrjen në shqyrtim të këtij pretendimi të ankuesit, trupi gjykues në seancën e datës 13.02.2019 vlerësoi të arsyeshme pyetjen e Komisionerit Publik lidhur me identifikimin e fakteve juridike, të cilat në vlerësimin e tij mund të përbënin provë në kuadër të vlerësimit të kriterit të

aftësive profesionale dhe të cilat, sipas tij, kishin mbetur pa hetuar nga Komisioni apo ishin hetuar në mënyrë të paplotë, duke i identifikuar ato për secilin prej denoncimeve objekt ankimi, në mënyrë individuale.

25.4 Trupi gjykues konstatoi se Komisioneri Publik nuk arriti të identifikonte faktet dhe rrethanat e mbetura të pahetuara apo të hetuara në mënyrë të paplotë nga Komisioni, për secilin prej denoncimeve për të cilat ai kishte kërkuar riçeljen e hetimit.

25.5 Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se investimi i tij në kontrollin e vendimeve të Komisionit bëhet mbi bazën e shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat ngrenë pretendime të argumentuara, qoftë në drejtim të nevojës për riçelje të hetimit nga ana e Kolegjit, të fakteve apo rrethanave të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes në kuadër të konstatimit në mënyrë të plotë të gjendjes faktike, qoftë në drejtim të kërkesës për vlerësim të ndryshëm të provave në funksion të konstatimit të ndryshëm të situatës faktike, si dhe në drejtim të mënyrës së zbatimit të ligjit nga ana e Komisionit. Për rrjedhojë, qartësia e Komisionerit në kërkesat e tij para Kolegjit vlerësohet e një rëndësie të veçantë, në kuadër të kontrollit efektiv dhe eficient të Kolegjit ndaj vendimeve të Komisionit, në mbrojtjen e interesit publik.

25.6 Trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve të administruara nga Komisioni, arriti në konkluzionin se këto denoncime janë shqyrtuar duke u hetuar dhe trajtuar nga Komisioni në mënyrë individuale dhe rezultatet për secilin prej tyre janë paraqitur në “Relacionin mbi rezultatet e hetimit”, pavarësisht se nuk kanë gjetur pasqyrim në të njëjtën mënyrë trajtimi në vendimin përfundimtar të tij.

25.7 Gjithashtu, pranë Kolegjit, më datë 05.02.2019, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, u depozitua denoncimi i shtetasit A. K., objekti i të cilit lidhet me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Ky denoncim iu bë me dije edhe palëve në proces. Komisioneri Publik u shpreh se e linte në çmimin e trupit gjykues vlerësimin dhe gjykimin e këtij denoncimi, ndërsa subjekti i rivlerësimit argumentoi se ky denoncim nuk paraqet asnjë të dhënë, indicie apo element që mund të ngrëjë dyshime për paaftësi profesionale apo të cenojë vlerësimin e Komisionit në lidhje me këtë kriter.

25.8 Për rrjedhojë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre denoncimeve, përfshirë denoncimin e shtetasit A. K., të depozituar në Kolegj gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, Kolegji arriti në përfundimin se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana, të cilat mund të përbëjnë provë në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

25.9 Për më tepër, lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se edhe në rastet kur për disa prej denoncimeve Komisioni ka kërkuar dokumentacion, në vendimin përfundimtar të tij nuk ka pasqyruar asnjë trajtim dhe vlerësim lidhur me to, Kolegji në analizë të dispozitave të zbatueshme të legjislacionit që normon procesin e rivlerësimit, lidhur me rëndësinë e marrjes në shqyrtim të denoncimeve të ardhura nga publiku dhe efektit që ato sjellin në procesin e rivlerësimit, arrin në konkluzionin se, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, denoncimet parashikohen nga legjislatori

si një burim potencial prove (në raport me faktet dhe rrethanat e denoncuara nga shtetasit), lidhur me vlerësimin e secilit prej kriterëve të procesit të rivlerësimit dhe, në këtë kuptim, Komisioni jo domosdoshmërisht nevojitet të arsyetojë në vendimin e tij vlerën ligjore të secilit prej denoncimeve, përveçse për ato që përmbajnë fakte dhe rrethana, të cilat pas hetimit të plotë të tyre janë vlerësuar se përbëjnë provë në këtë proces dhe kanë ndikuar në vendimmarrjen e Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjektit. Në çdo rast tjetër, mostrajtimi i denoncimeve në vendimin përfundimtar të Komisionit, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit të Komisionit.

26. *Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik për qëndrim jo të drejtë nga ana e Komisionit ndaj rezultateve të hetimit, sa i takon njëres prej dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor të realizuar nëpërmjet shortit, për vlerësimin profesional sipas nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, konkretisht asaj të referuar në vendim si Rasti 5, në të cilën rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka humbur afatin ligjor për ushtrimin e ankimit kundër vendimit nr. {***}, datë 21.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të të cilit kjo gjykatë kishte vendosur pushimin e çështjes penale ndaj të pandehurit G. D., i akuzuar për veprën penale “Refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, parashikuar në nenin 257/a/1 të Kodit Penal, trupi gjykues konstaton:*

26.1 Komisioni në vendimin e tij, lidhur me trajtimin e kësaj dosjeje penale, është shprehur: *Konstatohet se në këtë rast subjekti i rivlerësimit nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit. Nga ana e subjektit të rivlerësimit, më datë 07.07.2016, është bërë një kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit për një rast fator, sikurse është shprehur vetë prokurori, e dokumentuar kjo me dokumentacion. [...] Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e saj nr. {***} akti, datë 25.10.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit pranë gjykatës dhe, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “Gjykata krijon bindjen se nuk kemi të bëjmë as me rast fator dhe as me forcë madhore” dhe, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nuk i ka atribuar asnjë pasojë rezultatit final.*

26.2 Komisioneri Publik nëpërmjet ankimit shprehet se nuk është dakord me qëndrimin që ka mbajtur Komisioni ndaj rezultateve të hetimit lidhur me këtë dosje penale, duke pretenduar që fakti i pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, se nuk njeh mjaftueshëm praktikën gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të *rastit fator*, ngre dyshime për aftësitë profesionale të saj dhe se në kuptim të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas tij, subjekti në rastin konkret paraqet (i) mungesë të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, referuar nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, pasi shfaq mungesë të aftësisë së subjektit për të interpretuar ligjin dhe mungesë të analizës dhe argumentimit logjik që në rastin në fjalë ka sjellë si pasojë moskryerjen e detyrës nga ana e saj, si dhe (ii) mungesë të aftësisë organizative, referuar nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, për të përballuar ngarkesën në punë dhe për të administruar dosjet gjyqësore, mungesë që reflektohet me mosrespektimin e afateve ligjore.

26.3 Subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, lidhur me këtë shkak të ankimit, ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionerit Publik, sipas të cilit në trajtimin e çështjes penale në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mungesë të aftësive profesionale dhe atyre organizative, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016. Sipas saj, konkluzioni i Komisionerit Publik nuk mbështetet as në ligj dhe as në aktet dhe të dhënat e administruara gjatë hetimit në Komision. Subjekti pretendoi që rasti në fjalë është një ngjarje njerëzore, e cila ka ndodhur për shkaqe familjare që provohen nga aktet e administruara gjatë hetimit dhe se, për më tepër, njohja me praktikën gjyqësore në mënyrë të vazhdueshme është shprehje profesionalizmi dhe jo e kundërta.

26.4 Lidhur me këtë pretendim të Komisionerit Publik, trupi gjykues vlerëson se edhe pse subjekti i rivlerësimit pretendon se mund të ketë qenë në kushtet e pamundësisë për të ushtruar personalisht të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës brenda afatit ligjor, për sa kohë e konsideroi të padrejtë atë vendim, duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për të njoftuar organin e Prokurorisë për këtë pamundësi, pasi ky organ, për shkak të organizimit dhe mënyrës së funksionimit të tij, i kishte të gjitha mundësitë dhe mjetet ligjore që të mos e humbiste të drejtën e ankimit, por të mund ta ushtronte atë nëpërmjet një prokurori tjetër. Të gjitha përpjekjet e mëpasshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, për të riparuar pasojat e humbjes së afatit të ankimit u vlerësuan nga gjykata të papranueshme dhe, për pasojë, u rrëzua kërkesa e paraqitur prej saj për rivendosje në afat me arsyetimin se subjekti nuk ndodhej në kushtet e *rastit fator*.

26.5 Humbja e afatit të ankimit dhe pohimi nga ana e subjektit të rivlerësimit se, deri në momentin e mospranimit nga gjykata të kërkesës për rivendosje në afat, nuk e njihte mjaftueshëm praktikën gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të *rastit fator*, provon pretendimin e Komisionerit Publik se për rastin në fjalë, subjekti ka shfaqur mungesë të aftësive profesionale dhe atyre organizative. Megjithatë, duke marrë në konsideratë faktin që mangësia e konstatuar në njohjen e doktrinës dhe jurisprudencës së krijuar lidhur me konceptin juridik të *rastit fator*, si dhe mungesa e efektivitetit në menaxhimin e situatave komplekse gjatë ushtrimit të detyrës, paraqiten si situata të izoluara në kuadër të vlerësimit të tërësisë së burimeve mbi të cilat është kryer procesi i vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson që rezultati i këtij rasti nuk është i mjaftueshëm për t'u konsideruar mangësi profesionale, i cili, në mënyrë të pavarur, të mund të sjellë si pasojë marrjen e masës disiplinore, në kuptim të dispozitave të zbatueshme të ligjit nr. 84/2016, për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, por arrin në konkluzionin që problematika e evidentuar si më sipër, tregon dështim të organit të prokurorisë për të çuar deri në fund ndjekjen penale ndaj zyrtarëve publikë, të cilët kanë probleme ligjore me deklarin dhe fshehjen e pasurisë dhe cenon besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Për këtë arsye, ky rast vlerësohet se ndikon në rezultatin përfundimtar të rivlerësimit të subjektit, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

- 27.** Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik, për secilin prej dy kriterëve objekt ankimi, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet çmuarjes së akteve të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, dëgjimit të parashtrimeve të

palëve në proces, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, sipas parashikimeve në fuqi në kohën në të cilën kanë ndodhur faktet e provuara gjatë hetimit,

**trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,
bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:**

28. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurive, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruar, pasi ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter lidhur me burimet financiare të ligjshme për të justifikuar një pjesë të pasurive të saj, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
29. Nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
30. Për rrjedhojë, kërkimi i Komisionerit Publik për ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, me shumicë votash, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pikat 3 dhe 5, si dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.02.2019.

ANËTAR

Ardian HAJDARI
nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO
nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA
nënshkrimi / kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ
nënshkrimi

KRYESUES

Luan DACI
nënshkrimi

MENDIM PAKICE

Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 42, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nëpërmjet të cilit është vendosur ndryshimi i vendimit të sipërcituar të Komisionit dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari. Kam votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, i cili kishte konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Më poshtë, do të rendis arsyet e votës sime kundër, duke u ndalur dhe arsyetuar qëndrimet e mia kundër konkluzioneve që ka shumica e trupit gjykues në këtë çështje, pa përsëritur argumentet e dhëna nga shumica për çështje për të cilat kam ndarë të njëjtin qëndrim me të. Shkaqet për të cilat kam votuar kundër, rezultojnë të jenë ato për të cilat Kolegji ka vendosur ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, ndërsa për shkaqet e tjera të ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, të cilat janë gjendur edhe nga shumica të pambështetura e të padrejta, kam ndarë qëndrim të njëjtë me shumicën.

Kam votuar kundër shkaqeve të ngritura në ankimin e Komisionerit Publik që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë, për sa vijon.

I

1. *Verifikimi i ligjshmërisë së shumës prej 3.000.000 lekësh (përfshirë shumën prej 12.000 eurosh, të siguruar nga puna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Arabinë Saudite), deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burimi i krijimit të pasurisë për pjesën takuese 1/3 të truallit + ndërtesë, në Yzberisht, Tiranë, për të cilën Komisioneri Publik pretendon se:*
 - a. Hetimi i Komisionit ka qenë i mangët në lidhje me të ardhurat me burim emigracionin e bashkëshortit të subjektit në Greqi për periudhën 1997-2000, në drejtim të administrimit të dokumentacionit provues mbi ligjshmërinë e burimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura, si dhe të aftësisë së personit të lidhur për të kursyer gjatë kësaj periudhe.
 - b. Për ardhurat në vlerën prej 12.000 eurosh, të deklaruara si të realizuara nga puna e bashkëshortit të subjektit në vitin 2003, në Mbretërinë e Arabisë Saudite, ka mungesë hetimi dhe administrimi të dokumentacionit që provon mënyrën e kryerjes së pagesës dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura.
2. Qëndrimin të mbajtur nga shumica e trupit gjykues në përgjigje të pretendimeve të mësipërme, për sa i përket konstatimit të situatës se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, në shumën prej 3.000.000 lekësh, të deklaruara si burimi i krijimit të pasurisë tokë dhe shtëpi, të ndodhura në Yzberisht, nuk përmbushin kriteret e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për pasojë subjekti gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, sipas neneve 30 e 33 të ligjit nr. 84/2016 (paragrafi 20.22 i vendimit).

3. Në lidhje me këto shkaqe ankimi dhe qëndrimin të mbajtur prej shumicës, çmoj se duhen shqyrtuar dy elemente që lidhen me këtë çështje.

Së pari, provueshmëria ose jo e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë tokë arë + ndërtesë, të ndodhura në Yzberisht, Tiranë, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës.

Së dyti, provueshmëria e deklarimit dhe e pagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

4. Në lidhje me çështjen e parë, nga analiza e akteve të administruara e të shqyrtuara gjatë hetimit administrativ e gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykimin e zhvilluar para Kolegjit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të drejta pronësie në pjesën takuese 1/3 e pasurisë tokë arë dhe ndërtesës të regjistruar si pasuria me nr. {***}, në zonën kadastrale nr. {***} Yzberisht, Tiranë dhe vlerën prej 3.000.000 lekësh (përfshi këtu vlerën prej 12.000 eurosh) të siguruara nga puna e bashkëshortit në emigracion në vitet 1997-2000, kursimet familjare dhe të ardhurat nga puna në Arabinë Saudite në qershor-dhjetor 2003, si të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie. Fakte të rëndësishme, të cilat duhet t'i nënshtrohen vlerësimit në lidhje me këtë çështje, rezultojnë të jenë edhe:

i) periudha e fitimit të pronësisë mbi tokën dhe e ndërtimit informal të banesës, që përkojnë me vitet 2000-2002;

ii) fakti që subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore me bashkëshortin e saj në vitin 2001; si dhe

iii) fakti që ka fituar titullin magjistrat kur ka filluar të punojë si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në muajin tetor të vitit 2003.

5. Subjekti ka paraqitur disa akte shkresore që provojnë rrethana të rëndësishme në drejtim të mënyrës së fitimit të të ardhurave të përdorura si burim për krijimin e kësaj pasurie.

Për sa u përket të ardhurave të krijuara në emigracion nga bashkëshorti i saj në vitet 1997-2000, periudhë përpara se subjekti dhe bashkëshorti të lidhnin martesë ligjore, subjekti ka paraqitur këto akte shkresore:

i) Dokumentin e lëshuar nga Zyra e Punës, {***}, Republika Greke, me titull "Vërtetim A", lëshuar më datë 27.01.1998, që vërteton se në këtë datë z. A. S. ka depozituar kërkesën për pajisje me "Kartën e lejes së përkohshme të qëndrimit për të huajt", të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ndër të cilat edhe një kontratë pune dhe librezën e pullave të sigurimit;

ii) Kartën e qëndrimit nr. {***}, me afat kohor të kufizuar, me periudhë vlefshmërie 06.05.2000 - 05.05.2001, që i përket dosjes nr. {***}, datë {***}.

iii) Tri mandate, të cilat vërtetojnë blerje pullash sigurimi shoqëror nga Instituti Grek i Sigurimeve Shoqërore për muajt korrik, gusht dhe shtator të vitit 1998, në të cilat referohen të dhënat e një punëdhënësi me emrin F. N., me objekt të veprimtarisë rikonstrukcione metalike.

6. Në analizë të këtyre provave dhe shpjegimeve, të dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi mënyrën e fitimit të këtyre të ardhurave gjatë punës si emigrant të bashkëshortit në shtetin grek për këtë periudhë, kam çmuar se niveli i provueshmërisë për burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, si të ardhura që kanë ardhur nga puna si emigrant në shtetin grek, është e tillë që të krijoj bindjen për ligjshmërinë e krijimit të tyre në kuptim të burimit të ligjshëm, të kërkuar si një kusht kushtetues në nenin D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës, pavarësisht se janë të krijuara nëpërmjet një burimi të ndodhur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në këtë rast, duke u konsideruar si një nga mjetet për kërkimin e provës në kuptim të nenit 49, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, marrin vlerë provuese të rëndësishme për sa kohë që ato gjejnë mbështetje e harmonizohen me të dhënat e informacionet rreth këtij fakti, që japin aktet e cituara më lart, të paraqitura prej subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, e që konsiderohen prova në kuptim të nenit 49, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
7. Në këtë situatë faktike, vlerësoj se gjendemi edhe për arsye të ekzistencës së disa rrethanave që sipas vlerësimit tim e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *[...] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...].*

Mendoj se subjekti gjendet në këto rrethana për shkak të disa arsyeve:

1. Koha e krijimit të këtyre të ardhurave daton gati dy dekada para se të miratohej e të hynte në fuqi paketa kushtetuese e reformës në drejtësi e ligji nr. 84/2016, të cilët përcaktuan rregulla të reja e specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet e rivlerësimit për efekt të kontrollit e verifikimit të pasurive të tyre.
2. Fakti që në kohën e krijimit të tyre, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A. S., nuk e gëzonte statusin e bashkëshortit të znj. Antoneta Sevdari, e aq më pak statusin e bashkëshortit apo personit të lidhur të një subjekti rivlerësimi, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Për shkak të kësaj situatë, ai nuk kishte ndonjë detyrim ligjor të tregohej i kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tij në atë kohë përveç se, për sa ai ka çmuar të nevojshme sipas kujdesit të një qytetari normal e të paangazhuar në ndonjë detyrë publike dhe nevojës për shpjegime në lidhje me këto të ardhura.
3. Fakti që për shkak të një realiteti historik të zhvillimit të shoqërisë shqiptare në vitet e tranzicionit, shqetësimi parësor i qytetarëve të ndershëm e nevojtarë të vendit tonë në ato vite, nuk ishte ruajtja e kurimi i anës dokumentare të çdo lloj aktiviteti që u prodhonte të ardhura, sesa nevoja reale e nxjerrjes e realizimit të këtyre të ardhurave në funksion të qëllimit për të siguruar jetesën dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të tyre e të familjarëve të tyre, në situatën e një krize të mirëfilltë ekonomike, besimi e sigurie që kishte mbërthyer shtetin shqiptar në vitet 1997-1999.

4. Koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura, e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim, edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr përsipër të ruajë apo arkivojë dokumente të kësaj natyre për një periudhë kaq të gjatë kohe, madje as nga vetë institucionet shtetërore. Pavarësisht mungesës së njohurive mbi afatet që legjislacioni grek përcakton në këtë drejtim, mjafton të kujtojmë se legjislacioni shqiptar parashikon përgjithësisht afate më të shkurtra se periudha gati 20-vjeçare të ruajtjes e arkivimit të dokumenteve, periudha që variojnë nga 5 deri 10 vjet, por me vështirësi e në raste shumë specifike, për akte të një rëndësie të veçantë, mund të tejkalojnë këto afate. Edhe në këtë këndvështrim, mundësia për të pasur më tepër informacion për këtë periudhë, aq më tepër për ngjarje që nuk kanë ndodhur në territorin e vendit tonë, por në territorin e një vendi për legjislacionin e të cilit kemi shumë pak njohuri, mendoj se është një element më shumë për të konsideruar se gjendemi para rasteve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

8. Arsyet si më lart dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, në drejtim të të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i saj, në kohën kur z. A. S. ende nuk e kishte këtë cilësi, mbështeten me provat e paraqitura prej saj e të cituara më lart dhe duhet të kënaqnin nevojat e Kolegjit drejt krijimit të bindjes se ato të ardhura ishin krijuar ashtu si subjekti deklaronte, si në deklaratat periodike, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në shpjegimet që ajo dha gjatë procesit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, mendoj se duhet të analizohet edhe rrethana e cila lidhet me momentin e krijimit të këtyre të ardhurave, si të ardhura që janë krijuar nga personi i lidhur përpara periudhës së rivlerësimit, në kuptim të nenit 3, pika 12 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës me periudhë rivlerësimi do të kuptojmë: *“Periudha e rivlerësimit” është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji.*
9. Duke mos qenë dakord me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pasuritë e vëna para kësaj periudhe nuk janë objekt i verifikimit nga ligji nr. 84/2016, ndaj qëndrimin se organet e rivlerësimit në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, sipas detyrimit të parashikuar nga neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duhet të vlerësojnë nën frymën e qëllimit kushtetues krijimin e të ardhurave të krijuara në këtë periudhë nga subjektet e rivlerësimit apo personat e lidhur. Shqyrtimi i çështjes në zbatim të këtyre parimeve, gjykoj se është një element i rëndësishëm që kënaq qëllimin e shpallur në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se kryerja e reformës në drejtësi do të ndodhë, përveç të tjerave, thelbësisht për të rikthyer besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
10. Pasuritë e vëna nga subjekti i rivlerësimit, aq më tepër prej personave të lidhur, para periudhës së rivlerësimit, gjykoj se mund të plotësojnë e kënaqin nivelin diskrecionar për “justifikimin bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive” edhe për një nivel më të ulët të provave se sa do të duhej për të kënaqur këtë nivel, për pasuritë e vëna gjatë periudhës së rivlerësimit. Kjo mënyrë e të arsyetuarit lidhet natyrshëm me logjikën se këto pasuri presupozohen që janë vënë së paku duke mos përfituar e abuzuar me detyrën, për pasojë duke shmangur për këto pasuri mosbesimin e publikut drejt ligjshmërisë së tyre. Sigurisht që ky qëndrim nuk nënkupton

përjashtimin e këtyre pasurive nga kontrolli e verifikimi i ligjshmërisë së tyre, por vetëm një trajtim objektiv, sipas parimit të objektivitetit të parashikuar në nenin 14³⁵ të Kodit të Procedurave Administrative, në drejtim të nivelit të provueshmërisë së ligjshmërisë së burimit për krijimin e tyre.

11. Këtij argumenti mendoj se duhet t'i bashkëngjitet situata faktike e provuar e ekzistencës së pasurisë, për të cilën këto të ardhura kanë shërbyer si burim, përpara se subjekti të fillonte të ushtronte funksionin e magjistratit. Pra, edhe në drejtim të situatës faktike, provohet se këto të ardhura jo vetëm janë deklaruar se janë krijuar para periudhës së rivlerësimit, por edhe se kanë ekzistuar para kësaj periudhe, përderisa provohet që ato janë trupëzuar në një pasuri tokë + ndërtesë, që provohet se është ndërtuar para kësaj periudhe. Kjo e dhënë faktike minimizon pothuaj krejtësisht abuzimin e mundshëm me deklarimin se këto të ardhura kanë ekzistuar para fillimit të periudhës së rivlerësimit dhe u japin më shumë besueshmëri deklarimeve të subjektit në lidhje me to.

Qëndrimi i mbajtur nga shumica se këto të ardhura edhe në versionin se janë krijuar prej bashkëshortit në shtetin grek, nuk provojnë automatikisht ligjshmërinë e krijimit të tyre, pasi mund të jenë produkt edhe i një aktiviteti të paligjshëm, mendoj se është një qëndrim në shkelje të parimit kushtetues të prezumimit të pafajësisë, përderisa nuk rezulton asnjë e dhënë qoftë edhe e tërthortë se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit të ketë kryer në shtetin grek ndonjë aktivitet që do të konsiderohej apo dyshohej si i kundërligjshëm, që do të thotë një aktivitet kriminal.

12. Për sa më sipër, mendoj që të ardhurat e pretenduara se janë krijuar nga puna në emigracion, duhet të konsideroheshin se janë krijuar nëpërmjet një burimi të ligjshëm, siç është puna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shtetin grek.
13. Sa u takon të ardhurave në vlerën prej 12.000 eurosh, të deklaruara si të realizuara nga puna e bashkëshortit të subjektit në vitin 2003, nga puna në Mbretërinë e Arabisë Saudite, Komisioneri kundërshton vendimin e Komisionit për mungesë hetimi dhe administrimi të dokumentacionit që provon mënyrën e kryerjes së pagesës dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura.
14. Në lidhje me këto të ardhura që kanë shërbyer gjithashtu si burim për përfundimin e punimeve të brendshme dhe mobilimin e banesës së ndodhur në Yzberisht, subjekti i rivlerësimit në gjykimin tim ka provuar bindshëm faktin se ato janë krijuar nga burime të ligjshme, siç është puna e bashkëshortit në Mbretërinë e Arabisë Saudite në periudhën qershor-dhjetor 2003, për llogari të kompanisë {***} në të cilën ai ishte i punësuar në një marrëdhënie të rregullt pune. Subjekti i rivlerësimit arriti të provojë bindshëm faktin se bashkëshorti ka punuar për llogari të kompanisë në të cilën ishte i punësuar në Mbretërinë e Arabisë Saudite për një periudhë kohe 5-mujore në vitin 2003. Provat që provojnë ekzistencën e këtij fakti janë disa, të paraqitura prej subjektit gjatë

³⁵ Neni 14, Parimi i objektivitetit: "Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative".

procesit të rivlerësimit. Shkresa e paraqitur prej kompanisë {***}, e datës 15.01.2017, provon faktin se bashkëshorti i subjektit ka shkuar në periudhën e pretenduar për të punuar në Arabinë Saudite për llogari të një marrëdhënieje që kishte kjo kompani me shoqërinë {***}, e cila ishte e angazhuar në disa projekte për ndërtimin e rrugëve në atë vend. Sipas së njëjtës shkresë, kompania {***} deklaroi se bashkëshortit të subjektit i është paguar për punën e kryer atje, shuma prej 12.000 eurosh dhe se kjo punë ka qenë e normuar me një kontratë të veçantë, e cila nuk është e ruajtur për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Përveç kësaj shkrese, subjekti ka paraqitur dhe janë administruar si prova edhe pasaporta e bashkëshortit në të cilën pasqyrohen hyrjet dhe daljet në shtetin e Arabisë Saudite për periudhën e pretenduar për vitin 2003.

15. Gjithashtu, në një dokument tjetër shkresor, të lëshuar nga shoqëria {***}, Saudi Arabia Branch, i datës 21.06.2003, pasqyrohet fakti se bashkëshorti i subjektit ka pasur në përdorim disa automjete të kësaj shoqërie në Arabinë Saudite në kohën e pretenduar, të cilat janë poseduar për efekt të kryerjes së punës që ai kishte marrë përsipër të kryente atje. Rrethanat në të cilat është realizuar ky shërbim i bashkëshortit në Arabinë Saudite në ato vite, gjejnë pasqyrim edhe në disa fotografi që tregojnë tërthorazi përveç se për faktin se kjo punë është kryer, edhe shkallën e vështirësisë që e ka shoqëruar atë dhe, në këtë kontekst, flasin edhe për qasjen dhe zgjedhjen e bërë nga subjekti dhe bashkëshorti për të siguruar të ardhura nëpërmjet ofrimit të shërbimeve profesionale e përmes shumë vështirësish.
16. Në periudhën në të cilën është deklaruar se janë fituar këto të ardhura, rezultoi gjithashtu edhe një derdhje e shumës prej 5500 eurosh nga vetë subjekti i rivlerësimit në një llogari bankare të Tirana Bank, të cilat përkojnë me deklaratimet e subjektit e në mënyrë të tërthortë tregojnë për posedimin e kësaj shume parash, duke dhënë një argument më tepër për ekzistencën e tyre në atë kohë.
17. Mosdeklarimi i këtyre të ardhurave nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë në vitin 2003, për sa kohë që provohet burimi i ligjshëm i tyre dhe mbetet një episod i izoluar, për më tepër në deklaratimin e parë të pasurisë, nuk është një element i cili mund të ngarkojë sot me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, aq më tepër nën dritën e të gjitha fakteve që u përmendën më lart.
18. Për të gjitha këto arsye që u përshkruan më lart, kam gjykuar se edhe në drejtim të burimit të krijimit të kësaj të ardhure, subjekti i rivlerësimit ka provuar ligjshmërinë e tij nëpërmjet një prej mënyrave të parashikuara në ligjin nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, qëndrim ky që është ndarë edhe nga shumica në vendimin e saj.
19. Ndërkohë që gjykoj se subjekti i rivlerësimit provon bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë tokë arë + banesë, të ndodhur në Yzberisht, Tiranë, qoftë për të ardhurat nga emigracioni të bashkëshortit dhe ato që vijnë nga puna e tij në Arabinë Saudite në vitin 2003, para periudhës së rivlerësimit, gjithsej në vlerën 3.000.000 lekë, subjekti në vlerësimin tim nuk arriti në të njëjtin nivel provueshmërie për pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, pavarësisht ekzistencës së disa elementeve që të bëjnë të mendosh se detyrimet mund të jenë shlyer, por pa pasur mundësi të provohen.

bashkëshortit me këtë kompani për llogari të së cilës ai kreu shërbime profesionale edhe në shtetin e Arabisë Saudite ishte një marrëdhënie pune, (iii) detyrimin për shlyerjen e pagesave të sigurimeve e tatimeve në raport me shtetin shqiptar e kishte kompania dhe jo bashkëshorti si punëmarrës, në kuptim të nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Pavarësisht këtij arsyetimi që provon në gjykimin tim mirëbesimin e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në drejtim të faktit se kompania punëdhënëse ka paguar detyrimet karshi shtetit, këto të dhëna nuk provojnë bindshëm faktin se vërtet këto tatime janë paguar prej kompanisë.

II

22. Për sa i përket verifikimit të ligjshmërisë së shumës prej 19975,23 USD, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006, si e ardhur nga puna e bashkëshortit në Arabinë Saudite, për të cilën Komisioneri Publik pretendon se Komisioni është mjaftuar me gjendjen e faktit dhe konfirmimin e transfertës bankare dhe nuk ka hetuar dhe administruar dokumentacionin provues për ligjshmërinë e kësaj të ardhure, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, kam ndarë qëndrim të kundërt me konkluzionin e shumicës se për të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shumën prej 20000 USD, nga shërbimet e tij në Mbretërinë e Arabisë Saudite, nuk u arrit të provohet përmbushja e detyrimeve tatimore dhe, për pasojë, ato nuk përmbushin kriteret e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, duke konsideruar se edhe për këtë pasuri subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
23. Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga puna e tij si inxhinier pranë shoqërisë {***} s.p.a. në Arabinë Saudite në vitin 2006, në vlerën prej 20000 USD, në analizë të fakteve që kanë rezultuar të provuara gjatë hetimit administrativ, mendoj se subjekti ka provuar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre të ardhurave në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.
24. Në mbështetje të konkluzionit si më sipër, janë disa fakte që rezultojnë të provuara nga provat e paraqitura prej subjektit. *Së pari*, shuma prej 20.000 USD është transferuar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet një transferte bankare në bankën ProCredit, në datat 28.04.2006 dhe 13.07.2006, siç edhe ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike dhe atë të pasurisë *vetting*. Këto transferta janë kryer gjatë kohës që bashkëshorti i subjektit ndodhej në shtetin e Arabisë Saudite, siç provohet nga vulat hyrëse e dalëse në pasaportën e tij, sipas të cilave ai ka hyrë në këtë shtet në datën 27.02.2006 dhe ka dalë në datën 24.07.2006. I njëjti fakt konfirmohet edhe nga të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, për z. A. S. *Së dyti*, në vizën e lëshuar për bashkëshortin e subjektit e të gjendur në pasaportën e tij, shkruhet se qëllimi i dhënies së vizës është “Vizitë në kompaninë {***}”. Dy shtyrjet që i janë bërë vizës në shtetin e Arabisë Saudite, janë kryer në bazë të nenit 35 të ligjit mbi lejet e qëndrimit dhe tregojnë se bashkëshorti i subjektit qëndronte në atë shtet mbi bazën e një marrëdhënieje ligjore të rregullt e të provueshme, përderisa autoritet i kanë zgjatur lejen e qëndrimit në atë vend.

25. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion që tregon në mënyrë të detajuar e konkrete punën e kryer nga bashkëshorti e kolegët e tij, si inxhinierë në Arabinë Saudite në këtë periudhë. Gjykoj se analizimi dhe përmendja e këtyre fakteve janë të rëndësishëm për të mbështetur bindjen së bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit ka ushtruar shërbime profesionale në shtetin e Arabisë Saudite, në vitin 2006 dhe, për shkak të kësaj marrëdhënieje, si një nga format e burimit të të ardhurave të parashikuara nga neni 4 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, pavarësisht se me burim jashtë territorit, janë krijuar të ardhurat në shumën 20.000 USD, të cilat janë transferuar në llogarinë bankare të vetë subjektit të rivlerësimit, sipas transfertave të përshkruara më lart.
26. Në drejtim të pretendimit të ngritur në ankim nga Komisioneri Publik, se Komisioni nuk ka hetuar mjaftueshëm në drejtim të faktit nëse bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar ose jo detyrimet tatimore për këto të ardhura, sipas ligjit nr. 8438/1998, çmoj se Komisioni me të drejtë ka arritur në konkluzionin se detyrimi për pagimin e tatimit në këtë rast është mbajtur në burim në shtetin e Arabisë Saudite.
27. Për sa i përket provimit të këtij fakti, në gjykimin tim, duhet konsideruar se subjekti gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për arsye se vlerësoj që është tejet i vështirë, në mos i pamundur, sigurimi i dokumentacionit shkresor provues nga shteti arab për pagimin e detyrimeve në vitin 2006. Në këtë konkluzion arrihet duke konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka bërë mjaftueshëm përpjekje për të aksesuar bazën dokumentare të shoqërisë, por koha e kaluar e ka bërë të pamundur ruajtjen e dokumentacionit të kësaj natyre. Pretendimi se subjekti mund të kërkonte informacion drejtpërdrejt nga institucionet e shtetit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, vlerësoj se do të ishte një përpjekje jorealiste, konsideruar kohën e largët dhe respektimin në mënyrë të kufizuar të disa të drejtave të individëve në atë shtet, sipas të dhënave të organizatave ndërkombëtare të cilat e përkufizojnë atë si një shtet konservator, ku liritë dhe të drejtat e individit nuk respektohen sipas standardeve të pranuar ndërkombëtare³⁷.
28. Në këto kushte, mendoj se pavarësisht faktit që këto të ardhura mund të jenë tatuar në burim në Mbretërinë e Arabisë Saudite, kjo rrethanë nuk e shkarkon bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit nga detyrimi për deklarim të të ardhurave të fituara jashtë kufijve të shtetit shqiptar, në kuptim të nenit 13/2, pika 1, germa “f” e ligjit nr. 8438/1998, pranë autoriteteve tatimore vendase, duke qenë një individ rezident në Shqipëri, në kuptim të këtij ligji. Siç edhe përshkruhet nga shumica, ky detyrim është në fakt masa e nevojshme e parashikuar nga legjislacioni ynë tatimor për të vjelë tatimet mbi çdo të ardhur të realizuar nga shtetasit shqiptarë rezidentë. Por, në funksion të këtij qëllimi, duhet gjithashtu të veçohet fakti se ai kryhet për të vjelë diferencën që krijohet mes tatimit të paguar në shtetin ku janë krijuar të ardhurat me tatimin që do të duhej të paguhej në shtetin tonë,

³⁷ Referuar një dokumenti të publikuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Mbretëria e Arabisë Saudite kategorizohet si një vend me probleme të rëndësishme lidhur me liritë dhe të drejtat themelore të individit, si për mbrojtjen e të drejtave universale, si liria e shprehjes, përfshirë këtu dhe aksesimin në internet, lirinë e mbledhjes, të lëvizjes së lirë, lirinë e besimit dhe të drejtat e grave, fëmijëve dhe punëtorëve: <https://www.state.gov/documents/organization/186659.pdf>

dhe jo për të ngarkuar dyfish me tatim individin që krijon të ardhura jashtë vendit. Në mungesë të këtij deklarimi, që duhej të kryhej tek organet tatimore në kohën e realizimit të të ardhurave, pra në vitin 2006, por duke konsideruar të drejtë pretendimin se ato janë tatuar në burim në shtetin arab, vlerësoj se bëhet e pamundur të konkludohet për vlerën që duhej të paguhej pranë autoriteteve tona tatimore, si edhe për masën që ky mospagim afekton këto të ardhura, në kuptim të pasurisë së ligjshme, sipas parashikimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

29. Sidoqoftë, arsyetimi i mësipërm, në gjykimin tim, edhe duke pasur në konsideratë pretendimin që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit në drejtim të lindjes së këtij detyrimi vetëm me hyrjen në fuqi të deklaratës integrale të deklarimit të të ardhurave në vitin 2012, për shkak të paqartësisë ligjore rreth mënyrës së deklarimit të këtyre të ardhurave të krijuara jashtë vendit, të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, ka qenë e sinqertë në atë që ka deklaruar, se përderisa detyrimi ishte mbajtur në burim, ajo dhe bashkëshorti nuk kishin detyrimin për të deklaruar sërish në organet tatimore vendase, derisa deklaratat integrale nuk ishte aplikuar ende. Edhe fakti se kjo shumë është transferuar direkt në llogarinë bankare në emër të vetë subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, duke qenë ajo e ndërgjegjshme për qenien subjekt deklarimi në organet e kontrollit të pasurisë, si edhe deklarimi i kësaj shume që në deklaratat periodike të vitit 2006, tregon për mirëbesimin e subjektit se kjo e ardhur ishte krijuar në përputhje të plotë me legjislacionin dhe se nuk kishte asgjë për të fshehur.
30. Vlen të nënvizohet gjithashtu fakti se bashkëshorti i subjektit përgjatë gjithë kohës që ka ushtruar aktivitet si person fizik, i vetëpunësuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, aktivitet prej të cilit ai vetë kishte detyrimin të paguante detyrimet tatimore në organet tatimore vendase, rezulton të jetë një tatimpagues i rregullt, duke respektuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në këtë drejtim. Ky fakt i bashkëlidhet arsyetimit të mësipërm në drejtim të sjelljes e qasjes së subjektit të rivlerësimit në lidhje me respektimin e detyrimeve tatimore që ajo e bashkëshorti kanë pasur, duke provuar se të vetmet raste të diskutueshme e në vështirësi për të provuar pagimin e këtyre detyrimeve kanë qenë ato në të cilat tatimi duhej të mbahej në burim nga punëdhënësi e për të ardhura të krijuara nga puna jashtë territorit vendas.
31. Në konkluzion të analizës së mësipërme kryesisht mbi rrethanat e faktit, gjykoj se duhen veçuar dy konkluzione në funksion të analizës së mëpasshme ligjore që duhet bërë në raport me rrethanat e përshkruara më lart.
- a. Së pari*, se subjekti provoi bindshëm se pasuria tokë arë + banesë në pronësi të subjektit e bashkëshortit në pjesën 1/3 dhe pasuria likuiditet në vlerën 20000 USD janë krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës.
- b. Së dyti*, pavarësisht ekzistencës së arsyeve të forta drejt vërtetimit të faktit se për të ardhurat e përdorura për krijimin e pasurive si më lart, janë paguar detyrimet tatimore, ky fakt nuk u provua prej subjektit të rivlerësimit tej çdo dyshimi. Sikundër u provua në vlerësimin tim, mirëbesimi i subjektit drejt ekzistencës së pagimit të këtyre detyrimeve.

32. Këto dy konkluzione do të duhej të ishin bërë pjesë e analizës, në drejtim të faktit nëse kjo situatë të çonte drejt ndonjërit prej shkaqeve të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të parashikimeve kushtetuese të nenit D, pikat 4 e 5 dhe të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Konkluzionet e mësipërme do të duhej të analizoheshin, në vlerësimin tim, në drejtim të faktit nëse nga dispozitat kushtetuese dhe ato të ligjit nr. 84/2016, situata e mësipërme përbënte një nga rastet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra. Për t'i dhënë përgjigje kësaj çështjeje, është e nevojshme të kryhet analiza ligjore si më poshtë.

Neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës përcakton qëllimin e procesit të verifikimit e kontrollit të pasurisë në kuadër të procesit të rivlerësimit, për të identifikuar ato subjekte që kanë në pronësi më shumë pasuri nga sa mund të justifikojnë ligjërisht. Sipas kësaj dispozite, parashikohet se: *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.*

Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon parimin kushtetues të detyrimit të subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të tij. Në këtë normë kushtetuese, shprehimisht parashikohet: *Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë **bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.** Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.*

Në vijim e në zbatim të këtyre normave kushtetuese, ligji nr. 84/2016, në dispozitat e tij që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka ripërcaktuar parimet e mësipërme si më poshtë.

Neni 30 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i **ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre**, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.*

Neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve **për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.***

Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, **kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.***

Ndërsa neni 33 i ligjit nr. 84/2016, i cili rregullon mënyrën dhe procedurën se si organi i ILDKPKI-së kryen kontrollin e pasurisë e verifikimin e deklarimeve të subjektit në deklaratat e pasurisë, në pikën 5 të tij parashikon se në çfarë forme dhe në çfarë opsionesh ky organ mund të shprehet në lidhje me deklarin e bërë nga subjekti. Sipas kësaj dispozite: *Në përfundim të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se: a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi; b) **ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë**; c) është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit”.*

33. Ajo që dallohet qartësisht në të gjitha këto dispozita, duke filluar nga ato kushtetuese e më pas ato të ligjit *vetting*, është përcaktimi i detyrimit të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tyre. Në këtë kuptim, provueshmëria e këtij elementi thelbësor për procesin e rivlerësimit në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë do të përbëhet nga këto faza:

a. Provueshmëria e së ardhurës, si një gjendje fakti e cila do të duhet të provohet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet llojeve të provave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi e nga ligji nr. 84/2016 në veçanti.

b. Provueshmëria e burimit të ligjshëm të kësaj të ardhure, si një çështje fakti dhe analize ligjore, e cila do të duhej të provohet duke vendosur në një lidhje të drejtpërdrejtë të ardhurën me burimin e krijimit të saj e njëkohësisht ligjshmërinë e burimit. Në drejtim të këtij argumenti dhe definicionit të konceptit të burimit sipas këtij ligji, do të duhej të analizonim edhe nenin 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton se cila konsiderohet e ardhur e ligjshme për llogari të këtij procesi: *“Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.*

Në vijim, ligji nr. 8438/1998 “Mbi tatimin për të ardhurat”, në nenin 4 të tij parashikon jo në mënyrë shteruese, se cilat aktivitete të kryera nga individët shqiptarë do të konsiderohen se përfaqësojnë burime të të ardhurave të krijuara brenda territorit shqiptar, në kuptim të këtij ligji. Parashikimi i rasteve të përshkruara në këtë nen, lehtësisht lexohet si një mënyrë për të përshkruar në terma të përgjithshëm e përshkrues çdo aktivitet ligjor të lejuar në territorin e vendit, i cili, i normuar me rregulla të posaçme, do të konsiderohet si burim i krijimit të të ardhurave, të cilat do të jenë objekt i tatimit mbi të ardhurat personale. Në këndvështrim të përcaktimit të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, përcaktimi i këtyre burimeve do të duhej të kuptohej si përcaktimi i aktiviteteve të ligjshme apo burimeve të ligjshme të cilat krijojnë të ardhura të ligjshme për subjektin e rivlerësimit.

Sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 8438/1998, burimet e të ardhurave në Republikën e Shqipërisë janë: *Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon:*

a) të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë;

b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë; [...]

i) të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.

34. Në kuptim të dispozitave të mësipërme, subjekti i rivlerësimit duhet të provojë se si burim i krijimit të të ardhurave që do të konsiderohen të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 duhet të jetë një nga marrëdhëniet e përshkruara në nenin 4 të ligjit nr. 8438/1998 ose ndonjë formë tjetër, e cila jo vetëm nuk është e ndaluar nga legjislacioni, por duhet njëkohësisht të ketë një parashikim ligjor për lejimin e atij lloji aktiviteti. Në çështjen objekt gjykimi, të ardhurat e subjektit

të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, dhe të bashkëshortit të saj janë të krijuara, siç deklarohet dhe provohet, nga marrëdhëniet e punës që të dy bashkëshortët kanë pasur në vite në territorin shqiptar, si edhe nga marrëdhëniet e punës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shtetin e Greqisë dhe në Arabinë Saudite.

35. Në këtë kuptim, të gjitha pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, rezultojnë të jenë të krijuara duke pasur si burim të ardhurat që vijnë pikërisht nga këto marrëdhënie e të cilat provohet se kanë ekzistuar realisht dhe se këto të ardhura justifikojnë pasuritë e deklaruara nga subjekti. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit në këtë kuptim ka plotësuar detyrimin kushtetues të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara prej saj e personit të lidhur. Subjekti i rivlerësimit, në këto kushte, nuk mund të gjendet në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon rastin e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga hetimi administrativ dhe nga shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, nuk rezulton të jetë ngritur asnjëherë pretendimi për deklarime të rreme, të pasakta apo për fshehje të pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në këtë këndvështrim, subjekti ka kryer deklarime të sakta, të cilat përjashtojnë rrezikun e gjendjes në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, gerrat “c” e “ç” të ligjit nr. 84/2016.
36. Në vijim të këtij arsytimi, çmoj se aplikimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84 /2016 si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i pamundur. Kjo dispozitë, e cila parashikon: *Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: kur rezulton se ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji* - të referon për përcaktimin e shkakut konkret të shkarkimit, që konsiderohet se përfshihet te deklarimi i pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3, që referon te neni 33 i ligjit. Në analizë të rasteve të parashikuara te ky nen e të analizuara më lart, nuk ekziston asnjë prej situatave ligjore që do ta çonte subjektin e rivlerësimit drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sepse:
- o Nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
 - o Nuk ka bërë dëshmi të rreme.
 - o Nuk ka bërë fshehje të pasurisë.
 - o Nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.
37. Analiza dhe qëndrimi që mban shumica në lidhje me trajtimin si jo me burime të ligjshme të të ardhurave, për pasojë si të ardhura të paligjshme, për shkak se nuk provohet se janë paguar detyrimet tatimore, në vlerësimin tim meritojnë dhe duhen trajtuar në këndvështrim të nenit D, pikat 3 e 4 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Para së gjithash dua të nënvizoj faktin se kjo analizë, në gjykimin tim, do të shtrohej për zgjidhje vetëm në rastet kur subjekti provon bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave dhe nuk gjendet gjithashtu në kushtet e tjera që mund të shkaktojnë deklarim të pamjaftueshëm, sipas arsytimit më lart. Përveç kësaj rrethane, përjashtuese duhet të jetë edhe situata e përcaktuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e cila shkakton shkarkimin e subjektit të rivlerësimit në kuadër të një vlerësimi tërësor të të tria kriterëve e të procedurave, pavarësisht se nuk ekziston ndonjë shkak i drejtpërdrejtë shkarkimi që lidhet me secilin kriter, për sa kohë që institucionet e

rivlerësimin çmognë se subjekti ka cenuar besimin e publikut. Pra, që të thirret në zbatim neni 61, pika 1 për shkarkimin e subjektit, duhet që të mos ekzistojnë rrethanat e përmendura më lart, të cilat shkaktojnë shkarkimin e subjektit nga detyra për shkaqet e përshkruara më lart.

38. Në vlerësimin tim, kushti kushtetues i parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore* – lidhet në mënyrë integrale me situatën e parashikuar nga pika 4 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: *Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën. Ky parashikim kushtetues është implementuar më tej si një shkak i posaçëm shkarkimi në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës: Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të.*
39. Sipas përcaktimeve të këtyre dispozitave, ligjvënësi ka parashikuar përtej konceptit të burimit të ligjshëm për krijimin e pasurisë, të përshkruar më lart, si një detyrim kushtetues të panegociueshëm, edhe një institut tjetër që gjithashtu mat dhe vlerëson kriterin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit në këtë proces, pikërisht atë të pasurisë së ligjshme, e cila përbëhet sipas përcaktimit kushtetues nga të ardhurat të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet. Ligjvënësi ka dashur në këtë mënyrë të ngarkojë subjektin e rivlerësimit edhe me një detyrim tjetër karshi atij të provueshmërisë së burimit të ligjshëm për krijimin e pasurisë dhe pikërisht detyrimin e provueshmërisë së faktit se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit jo vetëm janë të krijuara nga burime të ligjshme, por ato duhet të jenë edhe të deklaruara e për to të jenë paguar tatimet. Kjo kategori e të ardhurave, për llogari të këtij ligji, do të konsiderohet si “pasuri e ligjshme”.
40. Vlen të nënvizohet fakti se ligji nr. 84/2016 nuk e lidh termin “pasuri” me pasurinë e ligjshme të përmendur në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, pasi në përkufizimin e pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet: *“Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit*. Prandaj, në përdorimin e termit “pasuri”, në drejtim të zbatimit të këtyre normave, duhet të shmanget përkufizimi i ligjit nr. 84 /2016, i cili jep përkufizimin e termit pasuri për efekt dhe qëllime të deklarimit të tyre në formularët e pasurisë dhe jo në kuptim e zberthim të termit “pasuri e ligjshme”, sipas nenit 61, pika 1. Në këtë rast, referimi për këtë koncept duhet të bëhet sipas përcaktimit që bëhet në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
41. Në vijim të këtij detyrimi, ligjvënësi qoftë në pikën 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, qoftë në pikën e parë të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ka parashikuar se përtej detyrimit për të provuar “pasurinë e ligjshme”, domethënë të ardhurat e tatuara, mungesa e tyre apo e provueshmërisë së tyre shndërrohet në një shkak kushtetues për shkarkim, vetëm në rast se të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit, të cilat në interpretim sistematik të normave kushtetuese, pikat 3 e 4 të

nenit D, janë të ardhurat në total të deklaruara prej subjektit e personave të lidhur me të e të justifikuar gjithmonë me burime të ligjshme, që do të rezultojnë më shumë se dyfishi i “pasurisë së ligjshme”, domethënë të ardhurat e subjektit me burime të ligjshme, por edhe të deklaruara e me detyrimet tatimore të paguara. Vetëm në këto kushte, subjekti i rivlerësimit do të prezumohet se ka kryer shkelje për shkak të kësaj dispozite e do të shkarkohet nga detyra nëse nuk provon të kundërtën.

42. Rregullimi i mësipërm, gjykoj se do parë në këndvështrim të historisë e realitetit të vendit tonë, në të cilin ka pasur e vazhdon të ketë mosfunksionim të mirë të administratës tatimore, gjendje e situatë informaliteti nga më të ndryshmet, të qenit në kushtet e evazionit për shumë faktorë e një sërë elementesh të tjera, të cilat kanë shkaktuar situatë evazioni e informaliteti, duke krijuar këtë realitet jo vetëm për shkak të sjelljes së individëve, por edhe për shkak të rrethanave specifike të zhvillimit të vendit tonë pas ndryshimit të sistemit të qeverisjes në vitet ‘90. Në gjykimin tim, legjislatori, duke konsideruar se edhe subjektet e rivlerësimit kanë qenë pjesë e këtij realiteti, ka marrë përsipër të amnistojë sjelljen e tyre në këtë situatë, por deri në një vlerë të caktuar, e cila është pikërisht dyfishi i cituar më lart, ose e shpjeguar me një raport tjetër, kur të ardhurat e tatuara janë më pak se gjysma e të ardhurave në total. Ky konvencion ligjor tregon se deri në çfarë niveli ligjvënësi nuk e ka barazuar sjelljen e subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me të me atë të një evazori që duhet të konsiderohet si shkelje në kuptim të këtij procesi e, për pasojë, duhet të ndëshkohet.
43. Në vijim të kësaj analize, në rastin objekt gjykimi, edhe sikur të pranohet se të ardhurat e pretenduara prej Komisionerit Publik e të pranuar nga shumica, janë të ardhura për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore, ato duhen parë në raport me të ardhurat totale të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur, për të konkluduar nëse subjekti gjendet ose jo në kushtet e ndëshkueshmërisë sipas nenit D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
44. Në analizë të deklarimeve të subjektit në këtë kuptim, rezulton se të ardhurat e deklaruara prej tij në vite janë në total në shumën prej 51.011.161 lekë, ndërsa të ardhurat e pretenduara si të patuara janë në vlerën 4.870.611 lekë³⁸. Duke zbritur këto dy vlera, do të përftojme të ardhurat e deklaruara e të tatuara ose “pasurinë e ligjshme” të subjektit, në kuptim të përcaktimit kushtetues, në vlerën prej 46.140.549 lekësh. Nga krahasimi i këtyre dy vlerave, 51.011.161 lekë “pasuri e deklaruar” me 46.140.549 lekë “pasuri e ligjshme” (ku rezulton se pasuria e patuar prej 4.870.611 lekësh përbën vetëm 9,5% të pasurisë së deklaruar në total), lehtësisht konstatohet se nuk gjendemi para kriterit kushtetues për shkarkim, për shkak të pasjes së dyfishit të pasurisë së ligjshme. Përkundrazi, konstatohet se pasuria e ligjshme e subjektit të rivlerësimit përbën 85% të të gjithë pasurisë së deklaruar prej tij.
45. Për arsyet e mësipërme, kam çmuar se nga vlerësimi i kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, nuk plotësohej asnjë prej kriterëve kushtetuese të parashikuara nga neni D, pikat 3 e

³⁸ Ku vlerat në USD janë konvertuar në lekë me kursin në vitin 2003: 1 USD = 133,65 lekë, dhe në vitin 2006: 1 USD = 93,67 lekë.

4 të Aneksit të Kushtetutës dhe asnjë prej kritereve ligjore të parashikuara nga neni 61, pikat 1 e 3 të ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin nga detyra.

III

Kam votuar gjithashtu kundër edhe në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga shumica për cenim të besimit të publikut, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 për sa vijon:

46. Në lidhje me trajtimin nga Komisioni të dosjes penale të përzgjedhur për vlerësim, referuar si Rasti 5, Komisioneri Publik ka pretenduar se fakti i pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit për mosnjohjen mjaftueshëm të praktikës gjyqësore në lidhje me trajtimin ligjor të “rastit fator” ngre dyshime për aftësinë profesionale të saj dhe se, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit paraqet mungesë të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor referuar nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, si dhe mungesë të aftësisë organizative, në referencë të nenit 74 të të njëjtit ligj, duke rezultuar në moskryerjen e detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit.
47. Kam ndarë qëndrim të kundërt me shumicën, e cila në përgjigje të këtij shkak ankimi ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit megjithëse nuk gjendet në kushtet e mungesës së aftësisë profesionale, siç ka pretenduar Komisioneri Publik, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë për shkak të sjelljes ndaj pranimit të parave të verifikuara se nuk janë paguar tatimet në vitin 2006 dhe mosushtrimin të ankimit në çështjen e analizuar në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale.
48. *Së pari*, në drejtim të këtij konkluzioni duhet të veçoj faktin se kushtet e parashikuara në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të sjelljes së subjektit që ka cenuar besimin e publikut, nuk janë pretenduar se kanë ekzistuar as nga Komisioneri Publik në ankimin e paraqitur prej tij. Në këtë këndvështrim, në vlerësimin tim, Kolegji ka tejkualuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke marrë përsipër të kryejë rolin e një organi rivlerësimi dhe jo të një gjykate që kontrollon veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përgjigje dhe brenda shkaqeve të ankimit që paraqitet në Kolegj prej palëve. Neni F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: *Kolegji i Apelitit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit.* Gjithashtu, edhe jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, e ka konsoliduar këtë rregull nëpërmjet përcaktimit të juridiksionit kontrollues të kësaj gjykate.
49. Në këto rrethana, Kolegji ka tejkualuar, në vlerësimin tim, shkaqet e ankimit në dëm të interesave të subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, duke cenuar të drejtën e saj për një proces të rregullt dhe zbatimin e parimit e kontradiktoritetit. Kolegji do të duhej të mbante qëndrim rreth shkakut të ngritur në ankim nga Komisioneri Publik në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe të mos analizonte dhe të kryente një vlerësim tërësor të tri kritereve të rivlerësimit, për sa kohë që një vlerësim të tillë Komisioneri Publik nuk e kishte pretenduar se duhej të kryhej në funksion të marrjes së masës disiplinore të shkarkimit.

50. Ndërkohë që ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i përket vlerësimit si të drejtë të vendimit të Komisionit në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit, referuar analizës së shkaqeve të ankimit të paraqitura nga Komisioneri, ndaj qëndrim të kundërt për sa i përket vlerësimit të një çështjeje të vetme lidhur me kriterin profesional, si një element që përcakton sipas Kolegjit besimin e publikut të subjektit i rivlerësimit.
51. Në vijim, pavarësisht qëndrimit të mësipërm në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes, po arsyetoj për qëndrimin e kundërt me shumicën edhe për sa i përket vlerësimit tërësor të të tria kritereve të rivlerësimit që bën Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
52. Gjykoj se besimi i publikut në drejtim të një subjekti rivlerësimi duhet të konsistojë në një analizë të plotë të të tria kritereve të procesit të rivlerësimit për të. Ky përcaktim nuk mund të jetë një standard klishe, por një vlerësim rast pas rasti i veprimtarisë së çdo subjekti rivlerësimi.
53. Në rastin objekt gjykimi, vihet re se Kolegji i referohet një rasti të vetëm, në të cilin procedimi penal ka përfunduar me vendimin që ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin për veprën penale të parashikuar nga neni 257 i Kodit Penal dhe për të cilin subjekti ka dështuar të ushtrojë ankim për shkaqe familjare, të shpjeguara prej saj. Arsyetimi i Kolegjit se ajo do të duhej të njoftonte eprorët e saj për pamundësinë e kryerjes së ankimit, bie ndesh me logjikën e shpjegimit të dhënë prej subjektit se pikërisht për shkak të rrethanave familjare, ankimi nuk ka qenë i mundur të ushtrohet, duke nënkuptuar këtu edhe kalimin e afatit procedural për ta kryer atë dhe moskonstatimin e këtij fakti. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, sipas pohimeve të vetë asaj dhe të verifikueshme në aktet që janë pjesë e dosjes gjyqësore, ka rezultuar se ajo ka ushtruar ndjekjen penale në mënyrë të suksesshme për çështje shumë të rëndësishme për publikun e financat e shtetit shqiptar, të cilat në këtë kuadër duhet të analizoheshin për të arritur në një konkluzion të drejtë e të baraspeshuar nëse subjekti e ka cenuar ose jo besimin e publikut vetëm me mosushtrimin e ankimit ndaj një vendimi të vetëm. Vlerësimi i vetëm një rasti sporadik nuk mund të jetë një standard i drejtë për të arritur në një konkluzion të tillë. Gjykata do të duhej të mbante në konsideratë në këto raste kontributin dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit në të tria kriteret e rivlerësimit dhe nuk mund të referohej vetëm tek analiza e një rasti të vetëm.
54. Edhe për sa i përket argumentit tjetër, të konsideruar si të vlerësueshëm nga Kolegji në drejtim të cenimit të besimit të publikut e që lidhet me pranimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të parave të krijuara nga puna e bashkëshortit në Arabinë Saudite, duke e ditur se ishin të patatuara, e gjë një argument jo të drejtë. Fillimisht, duhet të risjell në vëmendje faktin se ndryshe nga shumica, kam pranuar në pjesën më sipër se në vlerësimin tim, fakti i pagimit të tatimit në burim në Arabinë Saudite është një rrethanë e cila besohet se ka ndodhur, sipas një niveli të arsyeshëm provueshmërie dhe se gjithashtu edhe subjekti e ka perceptuar në këtë mënyrë përfitimin e këtyre të ardhurave. Por edhe sikur kjo rrethanë të mos provohej, në vlerësimin tim, do të ishte e padrejtë e rënduese në mënyrë joproporcionale të ngarkoje me përgjegjësi në këtë masë, pra me shkarkim nga detyra një subjekt rivlerësimi që gjendet në këto rrethana.
55. Duke abstraguuar rreth sa kam shprehur më lart, mendoj se pjesë e kësaj analize do të duhej para të tjerash të bëhej fakti se bashkëshorti i një subjekti rivlerësimi, zgjedh si mënyrë për të siguruar e

përmirësuar jetesën të bëjë një punë të vështirë, larg familjes, në kushte të vështira atmosferike e në terren, larg komoditetit që mund të ofronte një mënyrë tjetër për përfitimin e këtyre të ardhurave. Mendoj se kjo zgjedhje do të duhej të vlerësohej si një shenjë integriteti e përgjegjshmërie e subjektit të rivlerësimit edhe nga publiku, por edhe nga Kolegji, dhe të ishte pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të marrëdhënies së saj në raport me besimin e publikut. Gjithashtu, do të duhej të konsiderohej në këto rrethana edhe sjellja e sinqertë e subjektit të rivlerësimit në raport me deklarimin dhe trajtimin e këtyre të ardhurave, për sa kohë nuk vërehet asnjë përpjekje për të fshehur apo deklaruar të dhëna të pavërteta.

56. Për këto arsye, konkludoj se qëndrimi i mbajtur nga Kolegji për cënimin e besimit të publikut për shkaqet e mësipërme, është i padrejtë jo vetëm për shkak të mosrespektimit të normave procedurale që garantojnë procesin e rregullt, por edhe në thelbin e tij.
57. Për të gjitha arsyet e mësipërme, duke mos gjetur të mbështetura shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, kam gjykuar se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Antoneta Sevdari, prokurore në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është i drejtë dhe, si tillë, duhej të lihej në fuqi.

Gjyqtare

Ina RAMA

nënshkrimi